

# HEJZA

Agim Vinca, poet dhe studiues i letërsisë shqipe

**VLEN TË JETOHET PËR TË BUKURËN  
DHE TË VËRTETËN**

Nën thjerrë

# KËMBËNGULJE SHTETËRORE PËR KULTURË PA SHQIPTARË

**Për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, kultura ka qenë gjithmonë një mjet i fuqishëm për ruajtjen dhe përparimin e identitetit kombëtar**



**Nga Avni HALIMI**

Strukturat nacionaliste antishqiptare, të etabluara edhe në pushtetin aktual në RMV, madje në koordinim edhe me subjektet politike shqiptare, që me gjasë më shumë po i shërbejnë qeverisë vmroiste se sa interesit shqiptar, ashiqare po e shprehin angazhimin e tyre strategjik për shtetin komb, të cilin, për ta arritur duhet që sa më shumë të mohohet apo të marginalizohet prezenca e elementit shqiptar në shtet-formësimin e Maqedonisë së Veriut. Dhe, tërë ky synim po mjeçullohet kinse me fajet e BDI-së, e cila për 20 vite në qeveri nuk paska bërë asgjë, ose paska miratuar ligje që nuk janë në të mirë të shqiptarëve të këtushëm. Dhe, meqë nuk qenkan në të mirë të shqiptarëve të këtushëm, ndërsa nga ana tjetër, edhe po ua prishin maqedonasve matematikat për shtetin-komb, atëherë t'i eliminojmë të gjitha ato ligje e vendime tumorale dhe, të paktën, njëra palë të shohë hajër!

**Angazhim nacional për mohim të diversitetit kulturor**

Kjo iniciativë nacionaliste u ngrit fillimisht në fushën e kulturës, me synimin për ta abroguar fare ligjin kushtetues sipas të cilit gjuha shqipe (e emërtuar si gjuhë e 20 %-shit) e fiton statusin e gjuhës zyrtare. Nga ana tjetër, tërë "angazhimi kombëtar" i partive shqiptare që sot participojnë në pushtetin aktual shprehet te "autostrada e Bllacës", te rruga Tetovë-Prizren që mbase do të bëhet ndonjëherë si dhe te Korridori 8! "Projekt kombëtar" po llogaritet edhe zhbërja e rrjetit të kazinovë (thujse janë "qendra rekreative" ekskluzivisht në dëm të shqiptarëve)! Po kultura? Në çfarë derexhe e kemi kulturën? Po flitet se në Ministri të Kulturës dhe Turizmit zëvendës ministër qenka një shqiptar, të cilin akoma nuk e paska takuar ministri maqedonas! A e dinë subjektet shqiptare

që participojnë në qeveri se ky gjest nacionalit është i qëllimshëm dhe që përçon mesazhe kundër shqiptarëve dhe kulturës së tyre? A e dinë këta rishtakë në Qeverinë e Maqedonisë së Veriut se kjo sjellje do të thotë angazhim për mohimin e diversitetit kulturor dhe për ekskluzivitetin e kulturës maqedonase në këtë shtet?

A e kuptojnë këta rishtakë qeveritarë se sot e ke më të lehtë të hysh e të dalësh nëpër burgjet e Maqedonisë së Veriut, se sa të aplikojë shqiptari me projekte për programin nacional vjetor për kulturë? Janë një mori kërkesash dhe dokumentesh për konkurrim elektronik, të cilat, jo të gjithë i kanë të qarta, sidomos shqiptarët. Ky konkurrim online, sa vëzhgohet prej shqiptarëve, sa pranuesit e aplikimeve janë të sinqertë në raport me aplikimet e shqiptarëve? Këtë program vjetor e përbëjnë projektet që miratohen nga komisionet përkatëse? Kësaj radhe ministri maqedonas na e paska rritur standardin e profesionalizmit! A është ky qëllimi? Pa dyshim, jo! Qëllimi parësor është që në program të përzihen sa më pakë shqiptarë, ose ekskluzivisht ata shqiptarë që janë dashamirë dhe bartës të projekteve multi-kulti të kërkuar dhe përkrahur vetë nga maqedonasit! Ja një shembull! Për themelimin e komisionit në sektorin e Trashëgimisë Kulturore, ministri nuk lëshon as vendim, as rregullore, por, thjesht, udhëzim! Udhëzimi është një tekst që mund t'i nënshtrohet përmirësimit të vazhdueshëm, plotësimit apo të reduktimit, pa kurrfarë pasojash dhe sanksionesh ligjore për hartuesin! Pra, hapet një mundësi që të këndellen shqiptarët dhe të reagojnë ashpër për këto "stile maqedonase". Komisionet formohen me vendim, ndërsa paraprakisht miratohet edhe rregullorja përkatëse! Në këtë "udhëzim", për kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit, shprehet tërë ai kujdes i ministrit maqedonas

për të pamundësuar pjesëmarrjen e shqiptarëve në vlerësimin e projekteve përkatëse, por shpreh edhe përgjumjen e elementit shqiptar në këtë ministri dhe në Qeveri! Anëtar mund të zgjidhet ai që më së paku ka 10 vjet përvojë profesionale, që i ka të realizuar më së paku 5 projekte në lëmin përkatës! Epo cili shqiptar në Maqedoninë e Veriut e plotëson këtë kriter, i cili nuk kërkohet madje as në UNESCO! Pse shqiptarët "e pushtetit" lejojnë përcimim të tillë të shqiptarëve? Pse lejohen hartime të kriterëve të atilla, të cilat haptazi synojnë eliminimin e shqiptarëve nga pjesëmarrja në hartimin e programit vjetor për kulturë? Janë një sërë vlerash të trashëgimisë kulturore shqiptare, për të cilët maqedonasit as që kanë njohuri minimale! Shqiptarët në pushtet nuk duhet të lejojnë synime të tilla shovene dhe, që në start, duhet t'i kundërshtojnë, madje t'i kërcënojnë edhe me prishje të koalicionëve qeveritare, sepse duke i shëruar këto orekse antishqiptare, do t'ua lehtësojnë punën vetë shqiptarëve në nxjerrjen në pah të vlerave kulturore shqiptare. Kultura në Maqedoninë e Veriut, pa kulturën shqiptare është shumë diskutabile dhe e dyshimtë!

**Interpretimi shkencor që luftohet me pseudo-debate**

Në javën e parë të nëntorit të vitit 2024, mediat maqedonase dhe ato shqiptare informuan për një gjetje shekullore arkeologjike në Koroshishtën shqiptare të Strugës, të cilat datojnë qysh nga shekulli VI para Krishtit. Helmeta e bronzit, unazat e arit, enët e ndryshme, fletët metalike prej arit, por edhe format dhe dekorimet e ndryshme janë gjetur në një kompleks varrezash që, sipas arkeologut Fitni Dalipi, u takojnë fisit Ilir të Enkelejdevë, të cilët kanë banuar në krahinat përreth liqenit të Ohrit e që kanë krijuar dinastinë e parë të mbretërisë Ilire në fund të shekullit 5 para Krishtit. Njëqind e dhjetë vite

më parë, në të njëjtën zonë, arkeologët bullgarë dhe serbë kanë gjetur edhe rreth 500 artefakte të kësaj periudhe, të cilat mbi 300 u dërguan në Bullgari dhe mbi 200 në Serbi! Shteti i Maqedonisë së Veriut edhe sot e kësaj dite nuk e ka aktualizuar këtë vjedhje shekullore dhe nuk ka kërkuar që gjetjet arkeologjike të kthehen në vend prej nga u vodhën, ose, të paktën, të interpretohen si artefakte të gjetura në lokalitetet e Strugës të periudhës ilire. Natyrisht, kjo nuk do të ndodhë përderisa kemi një edukim e një mentalitet nacional maqedonas që mohon gjithçka shqiptare, që në kult nacional e ka ngritur luftën permanente deri në dëbim të shqiptarit të fundit nga "Maqedonia Antike" e sotme. Jemi dëshmitarë të një "debati" nëpër rrjetet sociale ku po vërehet një fushatë, një tendencë e stisur, mbase edhe e dirigjuar nga qarqe të caktuara që këto artefakte (meqë nuk po ia dalin që t'i vjedhin) t'i interpretojnë si "helene"! Pra, më lehtë iu vije që pasurinë e minierave kulturore të këtij trualli t'ua falin pasardhësve të helenëve se sa ato t'i evidentojnë si artefakte ilire dhe atyre t'u dalin zot shqiptarët! Shqiptarëve nuk u ka ngelur që ta bazojnë prejardhjen e vet ilire në këto 80 artefakte të gjetura në fshatin shqiptar të Strugës, sepse tashmë i kanë miliona gjetesh arkeologjike, miliona dokumente, dhjetëra muze nacionale, mijëra shkrime shkencore që e kanë vërtetuar dhe që edhe sot e deri në përjetësi e dëshmojnë gjenealogjinë e shqiptarëve qysh nga lashtësia para-ilire. Gjithçka paska filluar në vitin 2020, kur Shefit Shemshedini nga Koroshishta e Strugës, duke punuar arën e vet, paska hasur në gurë, ndërkaq më pas paska zbuluar një helmë të bronzit, të cilën e ka dorëzuar në Muzeun e Ohrit. Katër vite heshtje! Katër vite mosinteresim shqiptar për atë helmë. Katër vite përgatitje nacionale maqedonase për zbulim shekullor arkeologjik, i cili do të interpretohet si "i periudhës helene", duke shpresuar se do të rregullohen

raportet me popullin grek, ndërsa “shqiptarët nuk i bëjmë hesap"! Dhe sot kemi angazhimin e funksionarit shqiptar të lartë në qeverinë maqedonase (z. Arben Taravari), i cili thotë se ekspeditat e ardhshme arkeologjike nuk duhet të bëhen pa një shqiptarë në të tilla aktivitete! E para, cili është angazhimi kombëtar shqiptar për të prodhuar arkeologë profesionistë shqiptarë? E dyta, sa çon peshë interpretimi personal i një arkeologu shqiptar për një artefakt kur ai do të vendoset në institucionet shtetërore gjegjëse, ku prej portirit e deri te drejtori, që të gjithë janë maqedonas. E treta, pse shqiptarët nuk mbushen me mend se aktualisht po i shërbejnë një mentaliteti maqedonas, i cili nuk mund të tolerojë realitete që flasin se ky shtet është edhe i shqiptarëve, se kjo shoqëri funksionon falë edhe të shqiptarëve? Nuk bën punë arkeologu shqiptar sa marrëveshja historike në mes të maqedonasve dhe shqiptarëve për të kuptuar përfundimisht se ky nënqiell nuk mund të privatizohet, të personalizohet, të etnizohet. Popujt që jetojnë këtu janë thesar i jashtëzakonshëm mbi të cilën janë ngritur themelet edhe të shtetit të sotëm të Maqedonisë së Veriut, dhe këtë shtet nuk e sollën maqedonasit nga atje nga kanë ardhur që sot gjithçka brenda tij t’u takojë ekskluzivisht maqedonasve. Gjetjet arkeologjike në Strugë, janë një pasuri e jashtëzakonshme dhe një dëshmi e pasurive kulturore që kanë ndikuar dhe formuar identitetet e rajonit. Këto objekte, të cilat përfshijnë elemente të artit dhe kulturës, janë të lidhura ngushtë me popujt që kanë banuar këto territore në periudha të ndryshme, dhe si të tilla, ato janë një thesar i përbashkët për gjithë rajonin. Kërkesa e shkencës dhe e politikës për t’i interpretuar këto gjetje si pjesë të trashëgimisë të një populli të caktuar është një çështje delikate, e cila shpesh herë i shtyn shtetet të nxjerrin përfundime të njohura për të promovuar interesat kombëtare dhe identitar. Në këtë kontekst, gjetjet arkeologjike të Strugës janë shndërruar në një arenë diskutimi midis pseudo-shkencëtarëve që po shpërthejnë në rrjetet sociale. Ndarja e identiteteve dhe trashëgimive historike, duke i atribuuar

vetëm një grupi etnik të caktuar, nuk përputhet me realitetin e pasur dhe të shumë-dimensionuar të historisë së këtyre territoreve. Maqedonasit, siç është e njohur, janë një popull i formuar më vonë, pas shekullit VI, si rezultat i migrimeve sllave që ndodhën në Gadishullin Ballkanik. Ky fakt, i mbështetur nga dëshmitë historike dhe arkeologjike, do të thotë se lidhja e drejtpërdrejtë e maqedonasve të sotëm me civilizimin maqedonas të lashtë është shumë e dyshimtë. Përkundrazi, shumë historianë dhe studiues mbështesin idenë se trashëgimia kulturore dhe etnike e maqedonasve të sotëm është më shumë sllavesesahelene ose ilire. Nëse maqedonasit e sotëm duan të mbajnë lidhjen me qytetërimin maqedonas të lashtë, duhet të pranojnë që ky qytetërim është pjesë e një historie më të gjerë të Ballkanit, ku sidomos ilirët, përfshirë Enkelejdet, kanë luajtur një rol të rëndësishëm. Nëse pranojnë këtë, atëherë ata duhet të kuptojnë se nuk mund të veprojnë si pasardhës të një kombi të vetëm, por si pasardhës të një hapësire të përbashkët kulturore dhe historike, ku shqiptarët janë një pjesë e padiskutueshme integrale. A është e drejtë që një shtet ose një grup etnik të veçojë trashëgiminë kulturore të një rajoni, dhe ta paraqesë atë si të vetën ekskluzivisht? Përpjekjet për të nxjerrë përfundime të tilla të njëanshme dhe për të atribuuar trashëgiminë kulturore si ekskluzivisht maqedonase apo helene janë të rrezikshme, sepse mund të çojnë në përpjekje për të ndryshuar historinë dhe për të fshirë pjesë të rëndësishme të saj. Siç ka ndodhur me helmetën ilire, e cila dikur ka qenë e shfaqur si “Helmetë Ilire” ndërsa sot, në Muzeun maqedonas shfaqet si “helmete maqedonase”, dhe ky lloj interpretimi është i rrezikshëm dhe i dëmshëm për shkencën. Historia nuk është një mjet për të shërbyer interesave të ngushta kombëtare, por për të ndihmuar në njohjen dhe respektimin e diversitetit kulturor dhe të pasurive të përbashkëta. Në këtë aspekt, ky është një moment për të kërkuar një ndryshim të mentalitetit, që nuk do të thotë vetëm të respektohet dhe të njohim trashëgiminë e popujve të tjerë, por edhe të shprehim mirënjohje dhe admirim për të gjithë ata që kanë

kontribuar në krijimin e këtij qytetërimi, sidomos ndaj fiseve ilire.

**Institucionalizimi i kulturës si rezistencë kundër asimilimit**

Për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, kultura ka qenë gjithmonë një mjet i fuqishëm për ruajtjen dhe përparimin e identitetit kombëtar. Nisur nga konteksti historik dhe politik ku shqiptarët kanë përjetuar marginalizim dhe diskriminim, institucionalizimi i kulturës ka qenë si një element i domosdoshëm për të siguruar vazhdimësinë, zhvillimin dhe përfaqësimin e plotë të këtij komuniteti në shoqërinë e Maqedonisë së Veriut. Deri më sot, subjektet tona politike nuk kanë dhënë kurrfarë shenje se e kuptojnë “institucionalizimin e kulturës,” dhe as që e din se pse ky proces është aq i rëndësishëm për shqiptarët në këtë shtet? Institucionalizimi i kulturës përfshin krijimin dhe forcimin e institucioneve të qëndrueshme që mbështesin, zhvillojnë dhe përfaqësojnë trashëgiminë kulturore të një komuniteti. Këto institucione mund të jenë: qendra kulturore dhe muzeume, që ruajnë dhe promovojnë traditat dhe historinë kombëtare, teatrot, akademitë dhe organizata artistike, që nxisin zhvillimin e artit dhe letërsisë, institucionet shkencore, që ofrojnë studime dhe kërkime për kulturën dhe gjuhën, fondacionet dhe organizatat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, që sigurojnë ruajtjen e monumenteve dhe traditave, si dhe një varg institucionesh e subjektesh juridike e fizike që kontribuojnë në kultivimin zhvillimin e jetës kulturore të një komuniteti. Maqedonia e Veriut është një shtet multietnik, ku shqiptarët përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, rreth 30%. Megjithatë, shqiptarët historikisht janë përballur me politika asimiluese dhe përpjekje për t’i marginalizuar ata nga aspekti kulturor dhe gjuhësor, madje edhe duke i ngritur në kategori kushtetuese si populli 20%. Pra, institucionalizimi i kulturës për shqiptarët është një akt rezistence ndaj asimilimit dhe një mënyrë për të ruajtur dhe përçuar identitetin kombëtar ndër breza. Pa institucione të forta kulturore, shqiptarët rrezikojnë

humbjen e elementeve të rëndësishme të trashëgimisë së tyre, si gjuha, folklori, muzika, etnografia dhe zakonet tradicionale. Institucionet kulturore jo vetëm që ndihmojnë në ruajtjen e këtyre elementeve, por krijojnë edhe një platformë për promovimin e tyre, si brenda shtetit, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Institucionalizimi i kulturës është gjithashtu një çështje e barazisë dhe përfaqësimit. Në Maqedoninë e Veriut, institucionet kulturore të dominuara nga maqedonasit shpesh kanë anashkaluar kulturën shqiptare dhe nuk kanë përfshirë krijuesit shqiptarë në aktivitete dhe projekte të rëndësishme kombëtare. Krijimi i institucioneve kulturore shqiptare siguron që ky komunitet të ketë zërin dhe hapësirën e tij për të shprehur identitetin dhe kontributin e tij në mozaikun e kulturës së vendit. Në mungesë të institucioneve të forta dhe të financuara mirë, kultura shqiptare deri më sot ka qenë e varur nga iniciativa individuale dhe private, të cilat gjithnjë kanë qenë të pamjaftueshme për të përballuar sfidat strukturore dhe politike të një shteti që ka një histori të gjatë të marginalizimit të shqiptarëve. Institucionalizimi i kulturës nuk është i rëndësishëm vetëm për ruajtjen e identitetit shqiptar, por edhe për ndërtimin e një dialogu konstruktiv ndërmjet etnive të ndryshme në Maqedoninë e Veriut. Kur kultura shqiptare përfaqësohet në institucione zyrtare, ajo bëhet pjesë e përbashkët e historisë dhe trashëgimisë së vendit, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të hapur dhe të barabartë. Kjo përfshirje do të ndihmonte në zhdukjen e stereotipave dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve, duke krijuar një klimë të re të besimit dhe respektit të ndërsjellë. Në vend që kultura shqiptare të shikohet si një element i huaj ose i ndarë nga kultura shtetërore e Maqedonisë së Veriut, ajo do të integrohej në një kontekst më të gjerë multikulturor. Në fakt, ky është debati më urgjent dhe i vetmi që duhet të zhvillohet në këtë shtet, debat ky që do të shprehte pjekurinë e shoqërisë dhe të politikanëve tanë se janë të gatshëm të krijojnë shtet-bastion ku mbrohet me jetë mirëqenia dhe harmonia, shtylla këto të një shoqërie të civilizuar.

## Letër nga diaspora

# LIBRARIA LËVIZËSE

**Do të ishte një lloj Panairi i Librit, i cili e bën të kundërtën, i viziton ata që kanë nevojë, më shumë se për gjëra të tjera, për librin, për botimet e reja, i viziton ata që për shkak të rrethanave të ndryshme, nuk kanë mundësi të jenë në panairët e librit në Tiranë e Prishtinë**

**Neviana SHEHI/ Itali**

Në Tiranë, përkatësisht të pedonalja në afërsi të Teatrit Kombëtar (ku pritet të ndërtohet), ka kohë që qëndron një autobus i kuq, i cili është i mbushur me veshje kombëtare dhe aksesorë tjerë që janë pjesë e trashëgimisë kulturore. Në fakt, autobusi është një atraksion i vërtetë jo vetëm për turistët e huaj, por edhe më gjerë. Ky autobus, nëse nuk gaboj, ka lëvizur edhe në viset tjera shqiptare, si në Prishtinë e Shkup, gjë që është treguar si një mision i suksesshëm, sepse janë të paktë ata që nuk duan të kenë shenjë shqiptarie në shtëpitë e tyre. Po sikur një autobus të tillë ta mbushnim me libra dhe t’i mundësonim të udhëtojë nëpër shtetet e Europës Perëndimore, ku numri i shqiptarëve tashmë është i konsiderueshëm? Do të ishte një gjë e bukur, mbase shumë e qëlluar. Do të ishte një lloj Panairi i Librit, i cili e bën të kundërtën, i viziton ata që kanë nevojë, më shumë se për gjëra të tjera, për librin, për botimet e reja, i viziton ata që

për shkak të rrethanave të ndryshme, nuk kanë mundësi të jenë në panairët e librit në Tiranë e Prishtinë.

Po çfarë duhet bërë?

Ndonëse nuk është e thjeshtë, duhet të ulen botuesit shqiptarë, të arrijnë një ujdi, kuptohet, në bashkëpunim me institucionet shtetërore (sidomos me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme), të sigurojnë një autobus që do ta përshtatin në formë librarie, ta hartojnë planin dhe t’i japin

jetë Librarisë Lëvizëse. Paraprakisht do të bëhej një njoftim për të gjitha detajet, kurse për logjistikë do të kujdeseshin ambasadat dhe konsullatat shqiptare jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të Kosovës. Nuk do të ishte fare e vështirë që ky autobus një herë në vit të lëvizë, bie fjala nga Italia e deri në Suedi, duke kaluar nëpër ato shtete, ku koncentrimi i shqiptarëve vërtet është i madh. Me këtë do të dëshmohej se shtetet shqiptare mendojnë për diasporën jo vetëm në


kohën kur udhëheqjet e tyre kanë nevojë për votën e shtetasve të tyre, por se interesimi për ta është çështje permanent, në veçanti në aspektin shpirtëror, si një nevojë imediate për bashkatdhetarët kudo që ata jetojnë.

Sado që zhvillimi teknologjik mundëson mënyra të shumta të arritjes së librit në adresën e dhënë, megjithatë kjo formë ka simbolikën e vet, sepse në mjedise të caktuara i tubon shqiptarët, të cilët do të mund ta bëhen dëshmitarë të një organizimi më ndryshe, që në fakt është festë e librit, duke pasur mundësi të shohin e t’i prekin botimet e ndryshme, me çka do ta ndjejnë aromën e librit, aromën e gjuhës dhe të atdheut të tyre apo të prindërve të tyre. Me një angazhim gjithëpërfshirës Libraria Lëvizëse vërtet mund të lëvizë dhe të bëjë jehonë të madhe. Mjafton të kemi një vullnet të qëndrueshëm, dashuri dhe mbi të gjitha përgjegjësi dhe ndërgjegje për librin, artin, historinë, përkatësisht për ruajtjen dhe pasurimin e identitetit kombëtar. Mbi të gjitha, mjafton ta duam vetveten...



Agim Vinca, poet dhe studiues i letërsisë shqipe

# VLEN TË JETOHET PËR TË BUKURËN DHE TË VËRTETËN



**Tani që jemi në liri, na është zbehur shumë interesimi për art dhe letërsi. Isha para do ditësh në Tiranë, në një mbrëmje kushtuar Azem Shkrelit. Në sallë ishin gjithsej 17 veta, përfshirë edhe ne të panelit. Gjithë ajo Tiranë, me gjithë ata shkrimtarë, studiues, profesorë, botues, gazetarë, nuk denjoi ta nderonte si duhet Azem Shkrelin**

## Intervistoi: Avni HALIMI

Agim Vinca (1947) u lind në Veleshtë të Strugës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Strugë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në vitin 1970, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku edhe magjistroi dhe doktoroi. Ka qenë profesor në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, ku ligjëroi Letërsinë e sotme shqipe. Agim Vinca është njëri nga poetët më të njohur bashkëkohorë shqiptarë dhe njëri ndër studiuesit më të dalluar të letërsisë shqipe. Agim Vinca është autorë i këtyre veprave: Feniksi (poezi, 1972), Bregu i mallit (poezi, 1975), Në vend të biografisë (poezi, 1977), Aspekte të kritikës sonë (studim, 1977), Qasje (kritikë, 1980), Buzëdrinas (poezi, 1981), Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945-1980) (monografi historiko-letrare, 1985), Iz savremene albanske poezije u Jugoslaviji (antologji, Sarajevë, 1985), Arna dhe ëndrra (poezi, 1987), Orët e poezisë (kritikë letrare, 1990), Populli i pandalur (publicistikë, 1992), Alternativa letrare shqiptare (kritikë letrare, 1995), Kohë e keqe për lirikën (poezi, 1997), Shqiptarët mes mitit dhe realitetit (publicistikë, 1997), Dri (poezi, përzgjedhje, Tiranë, 1999), Sonet i vetmuar (poezi të vjetra dhe të reja, 2001), Kurs i teorive letrare. Prej antikës deri te postmodernizmi (libër teorik,

2002), Panteoni i ideve letrare (libër teorik, 2003), Fije të pakëputura (sprova letrare dhe kulturore, 2004), Kënga e hapur (antologji e komentuar, 2005), Psalmet e rrënjës (poezi, 2007), Zogj të plagosur/Verwundete Vögel (poezi shqip-gjermanisht, 2007), Letër Zotit (poezi, përzgjedhje, 2008), Bota sillet rreth jugut (poezi, përzgjedhje, 2008), Urnë e gjallë/ Urnë vie (poezi, rumanisht, 2010), (Po) etika e fjalës (kritikë letrare, 2010), Arti i reagimit (publicistikë, 2011), The world revolves around the south (poezi, anglisht, 2011), Muza e Mëmëdhut (antologji, 2012), Teori letrare (botim i dytë, i plotësuar, 2012), Svetot se vrti okolu jugot (poezi, maqedonisht, 2014), Mashat (poezi, greqisht, 2015), Ajo që u bë këngë (poemë, 2016), Une cloche à ton cou / Kambanë në qafë (poezi, frëngjisht, 2016), Metoda letrare (libër teorik, 2016), Nostalgi për kohërat e rrezikshme (poezi, 2017), Hije dhe dritë (eseistikë, 2019), Magjia e ligjërimin (intervistë, 2019), Andjeli propovjedaju jutrom (poezi, boshnjakisht, 2019), Ditari i pandemisë. Rrëfime nga karantina (2020), Konkubina dhe rrëfime të tjera (tregime, 2020), Palestina në tri pamje (udhëpërshkrim, 2021), Saga e shkronjave shqipe (Kongresi i Manastirit: të thëna dhe të pathëna), studim, 2022, Jetë e vdekje për qafuar (Ese & eulogji me një rrugatë në fund), 2023 dhe Antologji e lirikës shqipe të dashurisë, 2024. Me profesor Vincën bisedojmë për

shumë çështje, të cilat ndërlidhen me punën e tij, me aktualitetin në lëmin e letërsisë, kulturës etj.

**HEJZA:** Profesor, jeni ndër të paktët intelektualë që keni dhënë dorëheqje nga posti qeveritar, sepse keni vërejtur se po cenohet interesi kombëtar! Nuk ishte rëndë heqja dorë nga kolltuku për ta ruajtur integritetin intelektual si dhe interesin nacional? Ky veprim juaji nuk është parë shpesh në botën politike shqiptare! Si ndodhi?

**VINCA:** Kur u çlirua Kosova, në qershor të vitit 1999, nja një muaj a dy pas, mua ma ngarkuan detyrën e zëvendësministrit të Arsimit dhe të Shkencës në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës (QPK). Disa miq të mi të UÇK-së dhe të Konferencës së Rambujesë, pa më pyetur fare, më emërojnë në këtë post dhe njëri nga ata ma "kumtoi" vendimin një mbrëmje ndërsa po pija kafe në një nga lokalet e Prishtinës. Duke kaluar pranë tavolinës sime, më preku në sup dhe më tha: "Hej, shok, je emëruar zëvendësministër i Arsimit! Prej të hënës dil në punë!". Isha me dy miq të mi (një veprimtar i diasporës, që kishte ardhur në Kosovë pas shumë vjet ekzili dhe një gazetare e njohur, korrespondente e një rës nga radiot e jashtme) dhe pasi u largua "kumtari" (ishite z. Mehmet Hajrizi, zëvendëskryeministër i Qeverisë së Përkohshme) ata më uruan, por unë u

thashë: "Pritni pak, se nuk e di a të pranoj a jo?". Të dy njëzëri, por edhe të tjerë më vonë, më thanë: "Momenti historik e kërkon".

Kështu rezononim ne atëherë. Ishim entuziastë, por edhe jo sa duhet të vetëdijshëm se Kosova ishte protektorat dhe se Misioni i Kombeve të Bashkuara, i quajtur shkurt UNMIK, kishte ardhur ta qeveriste Kosovën deri në zgjidhjen e statusit përfundimtar të saj. Me insistimin e miqve dhe dakordimin e familjarëve e pranova detyrën e zëvendësministrit të Arsimit dhe Shkencës në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, natyrisht pa e ndërprerë punën në Fakultet, sepse për mua si njeri dhe intelektual, profesioni është (ka qenë gjithmonë) më i rëndësishëm se funksioni. Funksionet janë të përkohshme, sot je nesër s'je, kurse profesioni është i përhershëm, prandaj ai do vënë në plan të parë dhe do ushtruar me përkushtim e përgjegjësi të lartë. Shkoja për çdo ditë në mëngjes në zyrë dhe bashkë me kolegët e mi, bënim plane si ta nxirrnim arsimin shqip nga gjendja emergjente dhe si ta zhvillonim atë në të ardhmen. Ende e ruaj një fletore ku kam mbajtur shënime për të gjitha mbledhjet, angazhimet, përpjekjet, detyrat, takimet... Kështu deri në dhjetor 1999, kur u arrit marrëveshja ndërmjet UNMIK-ut dhe tri partive kryesore të Kosovës (LDK-së, PDK-së dhe LBD-së), për formimin e strukturave të përbashkëta:

departamenteve të para që ishin (sa më kujtohet): departamenti i ekonomisë, i drejtësisë, i pushtetit lokal, i arsimit (me shkencën) dhe i kulturës. Kjo ndodhi në kohën kur kryeadministrator i Kosovës ishte francezi Bernar Kushner (Bernard Kouchner). Këto departamente, që do të fillonin punën në fillim të vitit 2000, do të drejtoheshin nga dy drejtues: një vendor dhe një ndërkombëtar. Zyrtarisht unë isha "Cohed of Education". U zgjata pak me këtë pyetje, por më rrëmbu vala e kujtimeve...

**HEJZA:** Cilat qenë arsyet që ju dhatë dorëheqje?

**VINCA:** I kam shpjeguar në fjalën që mbajta me atë rast (në maj të vitit 2000) në konferencë shtypi në dhjetë pika, me titull "Nuk dua të jem ministër kukull as dekor". Këtë fjalë e pati publikuar shtypi i atëhershëm i Prishtinës, kurse unë vetë e kam përfshirë në librin "Arti i reagimit", prandaj nuk e shoh të udhës ta përfilas tani. Ne nuk kishim kompetenca; ishim të subordinuar, për të mos thënë dekor; fjalën e fundit e kishin ndërkombëtarët, të cilët nuk e njihnin sa duhet realitetin e Kosovës, as mentalitetin e njerëzve tanë, kurse vetë kishin, kush më shumë, kush më pak, një mentalitet neokolonial. U mundova dy-tre muaj ta ndryshoja mentalitetin e autoriteteve të UNMIK-ut, por pa sukses, prandaj vendosa ta lija "kolltukun" dhe të kthehesha te studentët në fakultet.

**HEJZA:** U rritët dhe po plakeni në Prishtinë, por asnjëherë nuk e harruat Strugën tuaj, struganët, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut! Kurrë nuk reshtët së shprehuri brengën kombëtare për statusin dhe situatat politike nëpër të cilën kaluan dhe po kalojnë këta shqiptarë! Natyrisht, pozita politike dhe shoqërore e sotme e shqiptarëve të Maqedonisë është e mirë, ndonëse lë shumë për të dëshiruar! Po kulturalisht? Ç'po ndodh me identitetin kulturor të këtyre shqiptarëve! Këta shqiptarë, a kanë nevojë për këshilla, qëndrime e për përkrahje akademike gjithëkombëtare?

**VINCA:** Për të rritur jam rritur në vendlindje: në Veleshtë, ku kam lindur dhe e kam kryer shkollën fillore dhe në Strugë, ku kreu shkollën e mesme (gjimnazin) dhe pastaj erdha për studime në Prishtinë. Pas diplomimit (1970) u ktheva në vendlindje dhe punova një vit shkollor (1971/72) në Gjimnazin e Strugës si mësuesdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe. Ndërkohë qeshë zgjedhur, me konkurs, asistent i Historisë së letërsisë shqipe në Fakultetin (atëherë Filozofik, tani Filologjik) dhe, pas disa dilemash e hezitimesh, kryesisht për shkaqe familjare, erdha



në Prishtinë dhe fillova punën në UP më 1 tetor 1972. Në këtë fakultet, ku do ta kryej edhe magjistraturën dhe doktoratën, do të punoj plot dyzet vjet, deri në pension, duke i kaluar pa kapërcime të gjitha gradat shkencore (nga magjistër te doktor i shkencave) dhe thirrjet akademike: nga asistent e ligjërues deri te docent e Profesor.

Po, është e vërtetë, ju keni të drejtë: po plakem në Prishtinë, në kryeqytetin e Republikës së Kosovës (dikur edhe të kreyt shqiptarisë këndeje kufirit), por vendlindjen, në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë të fjalës, natyrisht nuk e kam harruar. E si mund të harrohet vendlindja? Kush ia kthen shpinën vendlindjes, e mohon vetveten!

Lidhjet me vendlindjen? Krijimtaria ime poetike, siç pohon Robert Elsie, "mbështetet fort në truallin e vendlindjes e në vitet e fëmijërisë", por në situatat nëpër të cilat kemi kaluar ne si komb, veçanërisht shqiptarët e Maqedonisë, kjo nuk mjaftonte. Prej meje si njeri i lindur dhe i rritur në këtë trevë dhe si intelektual shqiptar kërkohej diç më shumë. Kërkohej t'i dilja zot këtij populli, këtyre njerëzve, t'i mbroja nga shpifjet, akuzat dhe represioni i egër, veçanërisht në vitet '80, por edhe ta elaboroja shkencërisht nga pikëpamja historike, kulturore dhe politike zgjidhjen e çështjes shqiptare në Maqedoni si një segment i rëndësishëm i çështjes shqiptare në përgjithësi.

Duke filluar nga viti 1986 e deri kur ra sistemi komunist dhe u legalizua pluralizmi politik, kam bërë shumë artikuj, letra, polemika e reagime, të cilat i kam botuar kryesisht në shtypin kroat (tek e përjavshmeja "Danas"),

sepse gazetat shqipe në Shkup dhe në Prishtinë nuk i botonin shkrimet e tilla. (Për ato në maqedonisht as që bëhej fjalë). Paraqitjet e tilla atëherë ishin të rralla, për të mos thënë se mungonin fare, sepse njerëzit frikësoheshin për fatin e tyre dhe të njerëzve të vet nga masat represive të pushtetit të atëhershëm, i cili nuk linte gjë pa bërë... Unë u shpalla "armik" dhe u bëra objekt i një fushate të egër, të paparë, që arriti deri aty sa edhe bashkëfshatarët e mi (kuptohet përfaqësuesit e organizatave shoqërore-politike të fshatit, vegla qorre të pushtetit) u ngritën kundër meje. ("Ne i gëzojmë të gjitha të drejtat", thuhej në letërën e shkruar nga Komiteti Komunal dhe të nënshkruar nga pesëshja analfabete). Në vitin 1992, këto shkrime, bashkë me disa të tjera, vështrime e trajtesa, i përmbledha në librin "Populli i pandalur", por nuk pushova së marruni edhe më tutje me fatin dhe statusin, për mua, ende të pazgjidhur të shqiptarëve që jetojnë në shtetin që sot quhet "Maqedonia e Veriut". E gjithë kjo kërkonte (dhe kërkon), natyrisht, pos guximit, edhe punë e energji, gjë që i faturohej punës sime krijuese, letrare e shkencore.

**HEJZA:** Krijuesit shqiptarë nga Maqedonia e Veriut kanë dhënë kontribut të konsiderueshëm për artin, letërsinë, kulturën kombëtare! Ju nuk e fshihni pakënaqësinë tuaj prej akademiku për përpjekjet për ta relativizuar apo edhe heshtur këtë kontribut!

**VINCA:** Letërsia shqipe që krijohet në Maqedoninë e Veriut është pjesë

integrale e letërsisë shqipe. Për shkak të rrethanave historike në të cilat ka jetuar dhe vazhdon të jetojë kombi shqiptar, letërsia shqipe krijohet në kontekste të ndryshme socio-kulturore, por ka një traditë të përbashkët letrare e kulturore dhe shkruhet në të njëjtën gjuhë: në gjuhën shqipe.


Pas Tiranës dhe Prishtinës, Shkupi është qendra e tretë e kulturës shqiptare të kohës sonë, prandaj tendencat për t'i anashkaluar vlerat letrare dhe artistike të krijuara në këtë pjesë të hapësirës shqiptare, ngado që të vijne ato, janë kundër-kulturore dhe kundër-kombëtare.

Para Luftës së Dytë Botërore flitej për Shkodrën, Korçën, Elbasanin, Vlorën dhe, natyrisht, edhe për Tiranën (pasi u bë kryeqytet) si qendra të kulturës shqiptare, kurse pas mbarimit të LDB-së, domethënë pas vitit 1945 dhe veçanërisht nga vitet '60 e këndeje, harta e vlerave letrare shqiptare ndryshon; faktor determinues i saj bëhet edhe Prishtina me tërë infrastrukturën e saj, botimet, shtypin, periodikun, mendimin kritik etj., pa harruar kurrsesi as Shkupin, ku trysnia ishte më e madhe dhe mundësitë më modeste. Konsideroj se pak është hetuar (dhe shpjeguar) ky fakt në studimet tona historiko-letrare, sikurse edhe në trajtesat me karakter sociokulturor.

**HEJZA:** Jemi dëshmitarë të botimeve që letërsisë shqipe i qasen në mënyrë parciale: antologji, prezantime në gjuhë të huaja etj. Kjo dukuri, madje, për çudi, është më e theksuar në Tiranë. Dikur kolegët tanë nga Tirana ankoheshin se nuk i linte regjimi të interesoheshin për Kosovën dhe shqiptarët jashtë kufijve, po tani kush i pengon?

**VINCA:** Fatkeqësisht po, ashtu është. Letërsia shqipe këndeje kufijve politike të shtetit shqiptar, për shkaqe politike e ideologjike, është zhvilluar një kohë të gjatë ndaras nga ajo që krijohet në Shqipëri. Kështu ka qenë plot njëzet vjet (1948-1968). Regjimi jugosllav ishte i interesuar të krijonte një entitet tjetër nga pjesa e kombit shqiptar e mbetur nën Jugosllavi, kurse Shqipëria socialiste, më shumë se për çështjen kombëtare, ishte e interesuar për "pastërtinë ideologjike". Gjendja ndryshon, pak a shumë, në gjysmën e dytë të viteve gjashtëdhjetë dhe përgjatë viteve shtatëdhjetë, kur rifillojnë kontaktet Kosovë-Shqipëri, vajtje-ardhjet e institucioneve kulturore, botimet letrare dhe shkencore etj. Siç e kam thënë edhe herë të tjera, për mua viti 1968 është vit i Rilindjes Kombëtare të shqiptarëve në ish-Jugosllavi dhe i fillimit të procesit të integritimit shpirtëror të shqiptarëve si komb. Mund të përmendim si shembuj





shënimin e 500-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriot-Skënderbeut; Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, shënimin e 60-vjetorit të Kongresit të Manastirit etj., ngjarje që flasin për një "rizbulim" të identitetit të mohuar një kohë të gjatë. Për brezin tim janë të paharrueshme shfaqjet teatrale, koncertet muzikore të ansambleve nga Shqipëria; ardhja e profesorëve nga Tirana për të ligjruar në Universitetin e Prishtinës, por edhe shkuarja jonë në Tiranë për kërkime shkencore e pjesëmarrje në konferenca shkencore etj. Në fushën e letërsisë duhet përmendur botimin e veprave jo vetëm të shkrimtarëve klasikë (Naimi, Noli, Mjeda, De Rada), disa nga të cilët për herë të parë, por edhe të autorëve bashkëkohorë si Spasse, Marko, Xoxa, Kadareja etj., sikundër edhe botimin e librave tanë, kryesisht me poezi, nga shtëpia botuese "Naim Frashëri" në Tiranë. Kjo atmosferë do të zgjasë deri në vitin 1981, kur, për shkak të demonstratave studentore të mars-prillit, të vlerësuar si "armiqësore", do të ndërpritet komunikimi Kosovë-Shqipëri (njëanshëm nga pala jugosllave) dhe do të fillojë një periudhë tjetër moskomunikimi, që do të zgjasë deri në rënien e sistemit komunist, në mos më shumë.

**HEJZA:** Kështu ishte dikur, po tani?

**VINCA:** Eh, tani është krejt tjetër situatë. Mirëpo, dreqi, thonë, nuk rri rehat! Barrierat artificiale politike e ideologjike, që dikur e ndanin hapësirën kulturore shqiptare, tashmë kanë rënë, por kanë dalë në skenë disa dukuri e shfaqje jonormale, që i kundërvihen procesit të integritimit shpirtëror të shqiptarëve si komb, pasojë e politikave të mbrapshta institucionale dhe individëve që janë në krye të tyre. Muri i madh që ndau shqiptarët gjysmë shekulli e më shumë, Kufiri në Qafëthanë e Morin, ka rënë ose është relativizuar në masë të madhe, por muret e vogla ende qëndrojnë në kokat e disa njerëzve, si inerci e së kaluarës a për ndonjë arsye tjetër, për mua të pakuptueshme dhe absurde.

**HEJZA:** A mund të na konkretizoni këtë që sapo thatët?

**VINCA:** Jo më larg se vitin e kaluar më është dashur të reagoj dy herë për projekte që i qasen letërsisë dhe kulturës shqiptare në mënyrë parcale. I pari ishte një ekspozitë me fotografi të

shkrimtarëve bashkëkohorë shqiptarë, ku në mesin e 46 shkrimtarëve nuk kishte asnjë jashtë kufijve politikë të Shqipërisë! Kjo ekspozitë që hapur në "Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit" të financuar nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë. Në hapje të ekspozitës merrnin pjesë një numër i madh shkrimtarësh nga Tirana, por asnjëri nga ata nuk e pa të udhës të reagojë për përjashtimin nga "albumi" të kolegëve të tyre nga Prishtina e Shkupi!

Projekti i dytë është edhe më drastik, sepse edhe autori i tij është më me renome. (Qëllimisht nuk po ua përmendi emrat kësaj radhe, por në shkrimet që pata botuar në shtyp dhe që i kam përfshirë edhe në librin "Jetë e vdekje përfaquar", kam folur me emër e mbiemër). Fjala është për "Antologjinë e poezisë moderne shqipe", hartuar nga "Poeti Laureat", në të cilën nuk ka asnjë poet nga Kosova, nga Maqedonia, nga Mali i Zi, nga Arbëreshët e Italisë dhe nga Diaspora! Nga gjithsej 59 (pesëdhjetë e nëntë) poetë, sa janë përfshirë në të, asnjë nuk është jashtë kufijve politikë të Shqipërisë! Si mund të quhet "antologji e poezisë shqipe" një libër si ky? Mos vallë letërsi shqipe është vetëm ajo që krijohet vetëm në Shqipërinë "xhuxhe", siç do të thoshte poeti Ali Podrimja?! Po ne që jetojmë e krijojmë këndej kufijve, a nuk shkruajmë shqip dhe a nuk i takojmë letërsisë kombëtare?! Për çudi, përsëri munguan reagimet e shkrimtarëve dhe studiuesve nga Tirana, madje pati edhe të tillë që u përpoqën ta "mbrojnë" autorin! Një shembull i tretë, pak më i lehtë, është libri "Të lirë" (2021) i Lea Ypit, një rrëfim interesant autobiografik që shtrihet deri në vitin 1997, ku nuk flitet fare për shqiptarët jashtë Shqipërisë dhe nuk gjen asnjë fjalë për represionin serb në Kosovë! Ia pata bërë këtë vërejtje autores në shkrimin që botova për këtë libër, por edhe në përrurimin e tij në Prishtinë dhe ajo e pranoi vërejtjen, duke thënë publikisht: "Kosova nuk ka qenë pjesë e ndërgjegjes sime deri në vitin 1999". Ç'do të thotë kjo? Për një pjesë të shqiptarëve, madje edhe intelektualë me ndikim që jetojnë në Perëndim, Kosova qenkësh bërë "pjesë e ndërgjegjes" atëherë kur drama e saj trazoi ndërgjegjen e botës!

**HEJZA:** T'i kthehemi edhe një herë pyetjes për pozitën politike dhe shoqërore të shqiptarëve të Maqedonisë. Si njeri që jeni marrë gjatë kohë me këtë çështje, çka do të na thoshit për pozitën

aktuale të shqiptarëve në RMV?

**VINCA:** Për pozitën politike të shqiptarëve në RMV, si thoni Ju, përkatësisht në Republikën e Maqedonisë, si quhej dikur, kam folur dhe kam shkruar shumë; e kam bërë këtë në intervistat që kam dhënë në medie dhe në shkrimet që kam botuar në shtyp ndër vite, të cilat i kam përfshirë në librat e mi publicistikë: "Populli i pandalur" (1992), "Shqiptarët mes mitit dhe realitetit" (1997) dhe "Arti i reagimit" (2011). Kam reaguar edhe atëherë kur fjala matej, si thuhet, në kalendarin e farmacistit, në vitet tetëdhjetë të shekullit të kaluar, duke e ngritur zërin kundër diskriminimit sistematik të shqiptarëve në të gjitha fushat e jetës; kam polemizuar me shumë intelektualë dhe politikanë maqedonas, duke e rrezikuar veten dhe familjarët e mi, sepse në atë kohë njerëzit që merrnin guximin t'i kundërviheshin politikës zyrtare shpallëshin "armiç", "nacionalistë", "irredentistë" e çkamos tjetër dhe si të tillë duheshin luftuar e linçuar me të gjitha mjetet. Kështu deri në fund të viteve '80, përkatësisht në fillim të viteve '90, kur ra sistemi komunist dhe filloi shpërbërja e Jugosllavisë si shtet. Edhe më vonë nuk kam pushuar së marruni me çështjen shqiptare në Maqedoni. E kam elaboruar gjerësisht këtë çështje nga aspekti historik, kulturor, politik, juridik, demografik etj. dhe kam propozuar edhe zgjidhje konkrete. Në vitin 1991, kur Maqedonia shpalli Referendumin për Pavarësi, duke e përkrahur parimisht këtë akt, e kam artikulluar dhe shtjelluar tezën mbi Maqedoninë si shtet shumetnik, shumëkonfesional dhe shumëkulturor, në të vërtetë si shtet dykombësh: i maqedonasve sllavë dhe i shqiptarëve etnikë - dhe i të tjerëve që jetojnë në të; shtet me demokraci konsensuale, ku vendimet për çështje me karakter etnik merren me konsensus dhe me gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare. Disa nga këto teza qenë përvetësuar nga Partia për Prosperitet Demokratik, por libri në të cilin i elaboroja ato që bllokuar nga njerëzit e Gligorovit të infiltruar në PPD, gjë që unë, naivi, do ta marr vesh me vonë. (I qeshë drejtuar PPD-së me kërkesë me shkrim që të ma mbështeste librin për botim; përgjigje me shkrim nuk mora kurrë, kurse me gojë më qe thënë: "nuk kemi mjet!")

**HEJZA:** Po përse, sipas Jush, ndodhte kjo?

**VINCA:** Albanofobia ka rrënjë të thella në Maqedoni dhe me sa shihet nuk çrrënjoset lehtë. Hegjemonizmi maqedonas nuk e duron trajtimin e shqiptarëve si të barabartë dhe nga ky aspekt nuk dallojnë shumë intelektualët nga politikanët. Madje, herë-herë ndodh e kundërta. Nuk ndryshoi kjo mendësi në Maqedoni as pas vitit 2001, kur këtu u bë një luftë "për të drejta". Lufta e detyroi palën maqedonase të ulëj rreth tryezës së bisedimeve me ndërmjetës ndërkombëtarë dhe të nënshkruante Marrëveshjen e Ohrit, por implementimi i saj, edhe ashtu siç qe, për mua me standarde të ulëta, çaloi, u zgjat e u stërkeq, jo vetëm për shkak të obstrukcioneve të palës maqedonase, por edhe për mungesë dijeje, përvojë e edhe vullneti politik të lidhshpimit shqiptar. Pushteti, veçanërisht në shtete si këto tonat në Ballkan, ku njerëzit e veshur me pushtet pasurohen brenda natës, i tjetërson njerëzit. Edhe dëshira e përfaqësuesve politikë të shqiptarëve për të qenë "çuna të mirë" dhe "demokratë të vërtetë" në sy të ndërkombëtarëve, nuk ka qenë pa ndikim në këtë mes. E ndërkombëtarët, me ç'tregojnë bathët, më shumë se për zgjidhjen e problemeve janë të interesuar për stabilitet politik.

**HEJZA:** Jam dakord me Ju, Profesor, me mendimin tuaj, por dëshiroj ta kthejmë vëmendjen pak nga arti dhe kultura...

**VINCA:** Edhe unë pajtohem, sepse Hejza është në radhë të parë revistë kulturore. Sa skandale kanë ndodhur me tekstet shkollore në gjuhën shqipe në Maqedoni? Ju i dini më mirë se unë: fyerjet më të rënda për shqiptarët, përdorimi i emërveve në trajtën sllave (Skopje për Shkup etj.) edhe në vitet nëntëdhjetë dhe sa e sa denigrime të tjera; të gjitha këto duke qenë autorët, përkthyesit, lektorët apo redaktorët shqiptarë, njerëz shumë herë edhe me grada shkencore, të cilët për "punën" e tyre kanë marrë honorar! Dhe nuk kanë bërë zë derisa janë "zbuluar" ose kanë bërë titullin e sharë, pa fije turpi, kur janë kritikuar. Si janë kryer shtimet dhe si janë marrë diplomat, masterat e doktoratat në universitetet shqiptare në Maqedoni? Tregohen anekdotat për këtë punë. Çfarë qëndrimi kanë mbajtur krijuesit shqiptarë në RMV, pjesa dërrmuese e tyre, ndaj manifestimeve letrare në të cilat marginalizohet letërsia dhe kultura shqiptare dhe ku nuk lejohet përdorimi i gjuhës shqipe, pra

mohohet gjuha në të cilën shkruajnë ata, domethënë ne? E kam fjalën në radhë të parë te festivali i njohur ndërkombëtar Mbrëmjet Strugane të Poezisë, që mbahet për çdo verë në Strugë. Kam qenë anëtar i Këshillit Drejtues të këtij manifestimi letrar në vitet 2002-2004. Kam bërë luftë të madhe, titanike, një dy vjet, dy e gjysmë, për ta ndryshuar trajtimin margjinal të letërsisë shqipe në këtë festival dhe qëndrimin përbuzës ndaj gjuhës shqipe. Nuk jam pajtuar me Statutin e ri të Festivalit, në të cilin nuk parashihej përdorimi i gjuhës shqipe, me pretekstin se ky qenkësh "manifestim ndërkombëtar" dhe kam dhënë dorëheqje para se të më kalonte mandati. Punën e Statutit e pata dërguar deri në Gjykatën Kushtetuese, duke u bërë edhe jurist e përkthyes, por kot. Nuk kisha mbështetjen e faktorit politik shqiptar. Dy-tri herë pata shkuar nga Prishtina në Shkup e Tetovë, por as Ministri i Drejtësisë, që atëherë ishte shqiptar, as zëvendëskryeministri, po ashtu shqiptar e, madje, as lideri i BDI-së, nuk pranuan të takoheshin me mua që luftoja si i marrë për statusin e gjuhës shqipe. Ose ishin të zënë me ndonjë "delegacion", ose në "udhëtim zyrtar", e ndodhte edhe të më iknin para sysh paturpësisht. Kur, më në fund, pas shumë përpjekjesh e përplasjesh, Statuti i MPS-së u aprovua me shumicë votash: 4 me 1, sepse e tillë ishte struktura e organit që vendoste për të, Këshillit Drejtues, mua s'më mbeti tjetër pos të jepja dorëheqje, jo në heshtje, por me një deklaratë drejtuar opinionit, ku shpjegoja arsyet e dorëheqjes. Pati reaguar kryetari i "bordit", Zoran Ançevski, një albanofob i thekur, mik personal i kryetarit të atëhershëm të shtetit, Cërvenkovskit, me të cilin unë zhvillova një polemikë të rreptë në gazetën "Utrinski vesnik". Nuk dua të flas për përmbajtjen e këtij teksti polemik, të botuar në dy vazhdimë dhe në tri faqe gazete më 18, 19-20 mars dhe më 7 prill 2005, të cilin e kam përfshirë, natyrisht shqip, në librin tim "(Po)etika e fjalës", të botuar në vitin 2010.

**HEJZA:** Por statusi i gjuhës shqipe, megjithatë ka ndryshuar...

**VINCA:** Po, ka ndryshuar. Në krahasim me të kaluarën, kur shqipen e gjeje vetëm në ndonjë tabelë dyqani a në ndonjë pllakë varreze, janë bërë ndryshime të mëdha, por problemi nuk është zgjidhur. Në Maqedoni gjykatësi shqiptar të gjykon maqedonisht edhe nëse i përket të njëjtës kombësi dhe flet të njëjtën gjuhë me ty; polici gjithashtu. Gjykatat dhe policia nuk e njohin gjuhën shqipe, as bankat. Për ushtrinë as mos të flasim. Në monedhën e Zvicrës, frangun e famshëm zviceran, teksti është në katër gjuhë (gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retoromanisht; kjo e fundit gjuhë e një grupi të vogël njerëzish), kurse në RMV as që mund të imagjinohet që në kartëmonedhën e denarit të ketë edhe ndonjë gërmë shqip! Ruana Zot! E Maqedonia e Veriut si shtet aspiron të integrohet në Europë, të bëhet anëtare e Bashkimit Europian dhe sa na përket ne shqiptarëve, po të mos ishin kontestimet nga Athina dhe Sofja, do të ishte bërë tashmë, pa zgjidhjen e qëndrueshme - kushtetuese - të statusit politik të bashkësisë së dytë etnike në RMV, për të cilën faktori politik shqiptar në Shkup s'bën zë, kurse Tirana zyrtare desh "u prish" me Bullgarinë për shkak të Maqedonisë!

**HEJZA:** Thonë, armiku në luftë e arrin kulmin e kriminalitetit kur fillon t'ia djegë librat kundërshtarit. Në tërheqje e sipër në luftën e fundit okupatori serb mori mijëra dokumente, libra kadastralë, artefakte... Dhe, nuk ia dolëm deri më sot, të paktën të kishim një film të metrazhit të gjatë, që do ta trajtonte artistikisht këtë lloj armiku! Filmi boshnjak "Në tokën e askujt", që mori çmimin "Oskar", bëri që 80 për qind



e opinionit amerikan për herë të parë të dëgjonin për boshnjakët, të kuptonin se çka kishte ndodhur në Bosnjë dhe me boshnjakët, dhe jo lufta e tmerrshme që zgjati plot katër vjet!

**VINCA:** Filmin boshnjak "Toka e askujt" (No Man's Land) nuk e kam parë, por kam lexuar dhe dëgjuar për të. Filmi është medium me ndikim të madh, prandaj e vlen të investohet në projekte filmike me peshë, siç bën e gjithë bota dhe siç kanë bërë edhe boshnjakët me filmin që përmendni ju. Për luftën çlirimtare të Kosovës dhe njerëzit që e bënë atë, në mënyrë të veçantë për ata që ranë në luftë, janë kompozuar këngë e vepra të tjera muzikore, janë shkruar poezi, vjersha e poema, janë publikuar vepra letrare e publicistike, janë shkruar ditarë e kujtime, janë hartuar edhe vepra shkencore nga fusha e historisë dhe shkencave të tjera humane, por mungon një vepër serioze nga fusha e "artit të shtatë", një film artistik me vlerë, që do ta plasonte të vërtetën për këtë luftë jo vetëm ndër ne, por edhe në botë. Ka kaluar një çerek shekulli nga mbarimi i luftës dhe ne ende nuk kemi një realizim të denjë artistik për këtë ngjarje të madhe historike të popullit tonë.

**HEJZA:** Si pasojë e modernizimit të përgjithshëm, a mund të themi se njerëzimi është në një proces të motorëzimit të kulturës! Këtij procesi a do t'i shpëtojë krijimtaria letrare, nëse jo, si do të dukej një letërsi e tillë? Ç'mendim keni për digjitalizimin e letërsisë? Libri elektronik - a është ky fundi i Bibliotekës klasike?

**VINCA:** Lidhur me këtë pyetje më lejoni të citoj dy nga shkrimtarët e mi të preferuar: Mario Vargas Ljosën dhe Amos Ozin. Nobelisti peruan Ljosa (Llosa), autori i romanit tronditës për diktaturën (diktaturat), "Festa e Cjapit", në një prononcim me rastin e marrjes së Çmimit Nobel (2010), shprehte, sa më kujtohet, shqetësim për fatin e librit, ndërsa shkrimtari dhe humanisti i madh izraelit, Amos Oz, në intervistën me Rudina Xhungën tonë, thotë: "... për mua librat janë diçka që e prek, e ndjen, diçka erotike, sensuale... Librin para se ta lexoj e prek, e fërkoj me mollëzat e gishtërinjve... Gjëja e dytë që bëj është ta nuhas. Çdo libër ka aromën e tij specifike... Çehovi ka aromë prej dollapi të vjetër ilaçesh; Remarku aromë baruti të përzier me aromën e biskotave dhe të kalvadosit".

Digjitalizimi i letërsisë, libri elektronik - fundi i Bibliotekës klasike? Jo. Besoj se ajo do të mbijetojë. (Unë, që të jem i sinqertë, do të doja që edhe këtë intervistë ta shihja të shtypur).

**HEJZA:** Subjektet tona politike, a kanë nevojë për një "Manual të politikave kulturore kombëtare", me peshë të një "kushtetute kulturore", pa njohjen e së cilës, nuk do të guxonin të drejtojnë shtet? Sot më shumë investojmë në çrrënjosjen e korrupsionit oktapodian se sa në kulturë!

**VINCA:** Po, mendoj se ka nevojë për një politikë kulturore të studiuar mirë dhe me strategji të qartë, të koordinuar me subjektet politike e shtetërore në nivel lokal dhe qendror. Mund të quhet edhe "manual", siç shpreheni ju. Ndërsa, sa i përket "korrupsionit oktapodian", ai nuk çrrënjohet pa u bërë reforma në drejtësi, vetingu dhe një SPAK i ri edhe në Kosovë e Maqedoni si në Shqipëri, ku, siç po shihet, askush nuk është më imun para ligjit. Korrupsioni, nepotizmi dhe paligjshmëria nxisin shpërnguljen, që është hëpërhë problemi numër një i shqiptarëve në Maqedoni dhe jo vetëm. Të vjen të qash kur i sheh bankat e zbrazura në shkollat që dikur gumëzhinin si zgjua bletësh! Shpërngulen edhe të tjerët, mund të thotë dikush dhe veçanërisht njerëzit e politikës, globalizëm është. E vërtetë. Mirëpo, pak më shumë dashuri për vendin ne shqiptarëve nuk do të na bënte keq! Aq më shumë që në këngë jemi patriotë të mëdhenj, të gatshëm me vdekë për komb e atdhe!

**HEJZA:** A kemi kritikë letrare dhe në ç'nivel e kemi mendimin mbi kulturën tonë krijuese, artistike?

**VINCA:** Kësaj pyetjeje po i përgjigjem, pjesërisht, me fjalët e pyetjes suaj vijuese: Kritika letrare ndër ne është një nga punët intelektuale më pak të vlerësuara. Ajo trajtohet si punë vullnetare e një "lexuesi", i cili dëshiron t'i shprehë përshtypjet e veta nga leximi i një veprë. Madje, kohëve të fundit, ka rënë në nivelin e informacionit të thjeshtë për veprën dhe të "reklamës" për të! Përse ndodh kështu? Kjo ndodh ngaqë kritika letrare dhe e arteve të tjera (muzikë, pikturë, teatër, film etj.) nuk trajtohet si veprimtari e rëndësishme shoqërore dhe nuk gëzon përkrahje institucionale. Asnjë gazetë jona a medium tjetër nuk ka njeri që

paguhet për këtë punë. Dikur ka pasur. Në "Rilindje" dhe në "Flakë", fjala vjen, përcillej rregullisht botimi i librave të rinj dhe ngjarjet e tjera kulturore, premiera shfaqjesh teatrore e filmash, ekspozita pikturash, koncerte të muzikës serioze apo edhe festivale muzikore. Tani pothuajse të gjitha këto kalojnë pa ndonjë vlerësim publik. Do të shtoja se te ne ka kritikë të klaneve, ku individë të ndryshëm i bëjnë elozhe njëri-tjetrit. Është shumë i pranishëm fenomeni i promovimeve: ende pa dalë libri nga shtypi caktohet dita e "festës", që fillon me lavde dhe përfundon me pije e meze. Media e shkruar dhe elektronikë shumë herë u jep më shumë hapësirë këtyre "eventeve", sesa veprave dhe ngjarjeve serioze letrare dhe shkencore. Disa i konsiderojnë sukses të kritikës dhe studimeve tona letrare punimet që bëhen për të marrë titullin magjistër a doktor shkence. S'do mend se ato paraqesin kontribut kur janë të shkruara mirë dhe me kritere shkencore, por kanë si destinim marrjen e një diplome. Shumë nga këta kandidatë nuk shkruajnë pothuajse asgjë më vonë, për të dëshmuar se letërsinë e kanë pasion, kurse kritikën vokacion. Kjo është pak a shumë gjendja e kritikës sonë në kohën në të cilën jetojmë.

**HEJZA:** Jemi me numrin më të madh të antologjive në botë. Pse bëhen dhe kush i bën antologjitë?

**VINCA:** Nuk e di a jemi vendi me numrin më të madh të antologjive në botë, nuk e besoj, sepse bota është e madhe dhe vetëm në Francë, fjala vjen, mjedis që unë pak a shumë e njoh, botohen me dhjetëra antologji në vit. Ka në mesin e tyre antologji tematike, historike, antologji të krijuesve të një shkolle a lëvizjeje letrare e, madje, edhe antologji të vargjeve unike. Unë në bibliotekën time kam një numër të madh sosh. Te ne antologji harton gjithkush, pa e njohur materien dhe pa i respektuar kriteret që kërkon një vepër e tillë. Antologji ka (mund të ketë) shumë në gjuhën shqipe, por antologjitë që vlejné numërohen në gishtat e dorës.


**HEJZA:** Në antologji të poezisë shqipe që përpilohet në Tiranë përfshihen edhe poetë nga Kosova, të cilët, mjerisht, lexuesi shqiptar nuk i njeh, madje as që ka dëgjuar ndonjëherë. Ju jeni, pa dyshim, ndër shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë shqiptarë. Nga ana tjetër, jeni plotësisht i vetëdijshëm

se lexuesi i Shqipërisë “as që ka dëgjuar” për ju? Apo ju ngushëllon fakti që të rinjtë shqiptarë nuk e njohin sot as Nolin, Fishtën, Konicën, Naim Frashërin a Jeronim de Radën, ndonëse shkollat e tyre mbajnë emrat e këtyre kolosëve të kulturës shqiptare!

**VINCA:** Unë si krijues njihem mjaft në Shqipëri (në Shqipërinë shtetërore): si poet dhe studiues i letërsisë, por edhe si publicist, kështu që s’kam arsye të ankojem. Natyrisht, njihem te lexuesit e moshës sime dhe pak më të rinj në moshë, tek ata që janë rritur me librin e shtypur dhe leximin klasik, por jo edhe te të rinjtë, këta të erës së smartfonëve dhe të rrjeteve sociale, të cilët edhe ashtu lexojnë pak ose nuk lexojnë fare letërsi. Kur isha Ministër i Arsimit i Kosovës pata shkuar në Tiranë për t’u takuar me homologun tim, prof. Ethem Rukën. Pas një procesi të gjatë pune, me komisione, i hartuam kriteret dhe e shpallëm konkursin për abetaren e përbashkët mbarëkombëtare. Me atë rast në Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë u bë një solemnitet, ku mora pjesë edhe unë. Të nesërmen pothuajse të gjitha gazetatat e Tiranës ma shkruanin emrin, në të vërtetë mbiemrin, gabimisht: Vinea, Vinica, Vinça! U revoltova: “Si ka mundësi? Unë jam botuar në Tiranë qysh në vitet ‘70!”, u thashë kolegëve të mi. Më qetësuan duke më thënë: “Profesor, janë bërë gazetarë çunat dhe gocat e Tiranës... Ia gabojnë emrin edhe Dhimitër Shuteriqi!”. (Shuteriqi ishte ende gjallë në atë kohë). Kur pas një kohe erdhi në vizitë në Prishtinë Ministri Ruka, iu “revanshuan” çunat dhe çikat e Prishtinës, duke ia shkruar dhe shqiptuar emrin “Ethem Uka”! Ec e hidhërohu me ta!

Por, problemi është serioz: ka rënë shumë niveli kulturor i medias shqiptare. Në radiotelevizionet tona, sikurse edhe në portale e gazeta, dëgjojmë e lexojmë jo rrallë gjëra skandaloze, për të qeshur dhe për të qarë. Po dëgjoja radion gjatë verës në Strugë (unë vazhdoj ta dua radion si medium). Ishte data 14 korrik, festa nacionale e Francës dhe Radio Shkupi fliste për këtë ngjarje. Mirëpo mënyra se si e bënte këtë tregonte injorancë të thellë. Dihet se Revolucioni Borgjez Francez i vitit 1789 filloi me marrjen e kështjellës së Bastijës (frëngjisht: Bastille; kështjellë mesjetare që shërbente si burg dhe që u mor nga kryengritësit më 14 korrik 1789, e cila pikërisht për këtë edhe u quajt “Dita e Bastijës”), por spikerja thoshte: “Dita e bastisjes!”, “Kryengritësit u nisën drejt bastisjes!” etj. Por, faji nuk është i spikerës; ajo lexonte tekstin që ia kishin shkruar të tjerët.

Injoranca është njëra anë e medaljes, tjetra është keqdashja. Shembujt janë të shumtë, por po përmendi një nga përvoja personale. Në mars të vitit 2020 mbajta një fjalë për Epopenë e UÇK-së dhe sakrificën e familjes Jashari. Pasi fola për ngjarjen e 5, 6 dhe 7 marsit 1998, iu referova edhe situatës aktuale në Kosovë, duke shprehur mendimin se bashkësia ndërkombëtare, BE-ja dhe SHBA-të, do të duhej ta inkurajonin luftën kundër korrupsionit e jo të insistonin te vazhdimi i dialogut me Serbinë. Fjala u prit mirë dhe “baca Rifat” (Rifat Jashari), që ishte i pranishëm në sallë, u ngrit dhe më përqafoi. Por, ç’ndodhi? Ende pa u kthyer në shtëpi, njëri nga portalet më të lexuara në hapësirën shqiptare kishte publikuar “express” lajmin me titull: “Agim Vinca sulmon ashpër imperializmin amerikan dhe ambasadorin Grenell”. As e kisha shqiptuar togfjalëshin “imperializëm amerikan” (nuk e kam bërë këtë as në kohën e komunizmit) dhe as e kisha përmendur emrin e të dërguarit të presidentit Tramp për Ballkanin, R. Grenellit. Ç’të bëja: ta demantoja? Dhe si, në ç’mënyrë? Preferova t’ua dërgoja për botim fjalën që kisha mbajtur, në mënyrë që lexuesit të shihnin se ç’kisha



thënë në të vërtetë. E botuan me dy ditë vonesë. Shpifja dhe gënjeshtria kanë qenë gjithmonë problem i njerëzimit, por ndër ne, hic et nunc, ato sikur kanë fituar të drejtën e qytetarisë. Shileri thoshte se shpifja është gjëja më e shëmtuar në botë, por në kohën e tij nuk kishte internet, portale e You Tube, që e multiplikon atë sa çel e mëshel sytë, siç ndodh në kohën tonë!

**HEJZA:** Si e shihni perspektivën e shqiptarëve në Maqedoni, jo vetëm në planin politik e shoqëror, por edhe në atë kulturor, arsimor e shpirtëror?

**VINCA:** Për problemet politike, sidomos për raportet shqiptaro-maqedonase është folur mjaft, ka ardhur koha të flasim pak edhe për problemet qytetëruese, për raportin e shqiptarëve me vetveten; të kombit me fenë; për gjendjen në arsim etj. Ku jemi, ç’bëjmë, nga shkojmë? Quo vadis, shoqëri shqiptare? Verën që shkoi qëndrova rreth një muaj në Strugë. Kur shkoi në vendlindje, unë zakonisht nuk punoj (e kam fjalën për punën krijuese intelektuale), por shoh, vërej, dëgjoj. Dhe mbaj shënime. Një ditë prej ditësh, me një mikun tim, bëmë një “turne” nëpër fshatrat e Strugës. Për një gjysmë dite i kaluam me makinë katundet: Bixhovë, Livadhë, Koroshishtë, Zhepin, Dollogozhdë, Tatesh i Poshtëm, Tatesh i Epërm, Dobovjan, Tashmarunisht, Vevçan, Oktis, Belicë e Poshtme, Zagraçan, Shum, Teferiç, për t’u khyer sërish në Strugë, gjithsej 83 kilometra rrugë. Diku hëngrëm diçka, diku pimë, diku bëmë një vizitë... Në Dollogozhdë vizituam varrin e dëshmorit Nuri Mazari, të njohur si “Komandant Struga”, të rregulluar mirë, ashtu siç e meriton. Mori pjesë në tri luftëra (të Kosovës, të Preshevës dhe të Maqedonisë) dhe u vra në mënyrë enigmatike po aq sa edhe banale në vendlindje. Një metaforë e gjallë e jetës, mentalitetit dhe historisë shqiptare!

U larguam nga varrezat, tek prehej edhe një “komandant” tjetër, për mua i panjohur, dhe vazhduam rrugën. Kaluam Zabelin e Begut dhe zbritëm në fushë. Në Tateshin e Poshtëm na doli para një xhami me katër minare në ndërtim e sipër. Jo një e dy, as tri, por katër minare! Nuk më shkon ndër mend t’ia kontestoj askujt të drejtën e besimit, përkundrazi, ajo është e drejtë e patjetërsueshme e gjithsecilit. E gjykoj ndalimin e fesë me ligj në kohën e komunizmit në Shqipëri, ndërkohë

që këndeje nga ne feja favorizohej. Por, me sa e njoh unë doktrinën islame, harxhimet e tepërta, qoftë edhe për objekte fetare, janë haram. Profeti Muhamed ishte njeri modest, kurse lutja drejtuar Zotit pranohet kudo, qoftë edhe në kasolle me kashtë, mjafton që ta thuash me zemër... Bashkudhëtari im, arsimtar në Veleshtë, më thotë, gjysmë me shaka, se në fshat ka gjithsej pesë veta që falen në xhami, “tre me një këmbë në varr, dy sagllam”, duke shtuar se fshati nuk ka ujë, kurse shkolla është në gjendje të mjerueshme!... Harxhimet që bëhen në dasma e zifafete në fshatrat tona janë enorme. Sa ushqimi hidhet poshtë, sa euroja e dollari “derdhet” për muzikën! Sa harxhojmë ne për ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore, materiale dhe shpirtërore, për shkolla, biblioteka, spitale, për fëmijët me nevoja speciale...? Unë e di se kjo është punë e shtetit, por shteti bën punën e vet ashtu si do dhe si di, kurse ne duhet të mbajmë llogari për të ardhmen tonë si komb dhe si shoqëri. Në Strugë nuk ka librari, kurse në qendër të qytetit shiten ditë e natë mevludë e ilmihalë dhe të shurdhron muzika tallava. Në disa restorante nuk serviret as edhe një gotë birrë në pikë të verës, por lejohet të pish duhan pranë foshnjave që thithin biberonë...

Unë po sjell shembuj nga treva ku kam lindur, por e tillë, në mos edhe më drastike, është gjendja në krejt Maqedoninë Perëndimore, e aty-këtu edhe në Kosovë e Shqipëri. Për mua shoqëria shqiptare në Maqedoni ballafaqohet me probleme të shumta qytetëruese dhe është detyrë e inteligjencies t’i evidencojë dhe debatojë për to. Qytetet tona s’kanë librari, ndërsa bibliotekat kanë mbetur me po atë fond librash nga koha e “baba Qemos”... Tjetër punë pastaj sa lexohet libri edhe nga ata që mbajnë mësim në universitete. Më shkroi këto ditë një mik shkrimtar nga qyteti buzë Vardarit, duke ma nisur librin e tij më të ri: “nga mosreagimet, as pozitive, as negative, për librat e mi, më është krijuar bindja se po shkruaj kot”. E keqja është se as shkrimtarët, me pak përjashtime, nuk e lexojnë njëri-tjetrin. Vetëm te ne dhe askund tjetër në botë ka “shkrimtarë” që më shumë shkruajnë se ç’lexojnë!

**HEJZA:** Po kontaktet me lexuesit, komunikimi me ta çfarë është; sa nderohen shkrimtarët dhe krijuesit e njohur, që nuk janë më në mesin e të gjallëve,?

**VINCA:** Nuk e di pse e si, i dashur Avni,

por ne na kanë rënë energjitë krijuese. Tani që jemi në liri, na është zbehur shumë interesimi për art dhe letërsi. Isha para do ditësh në Tiranë, në një mbrëmje kushtuar Azem Shkreli. Në sallë ishin gjithsej 17 veta, përfshirë edhe ne të panelit. Gjithë ajo Tiranë, me gjithë ata shkrimtarë, studiues, profesorë, botues, gazetarë, nuk denjoi ta nderonte si duhet Azem Shkrelin. Nuk ishte i pranishëm asnjë shkrimtar i njohur, me përjashtim të një poeti gjysmë të rrokatur. Në vitin 1997 Azemi pati shkruar vjershën “Këngë e turpshme” si reagim ndaj ngjarjeve të marsit. Por, edhe mbrëmja e 25 tetorit kushtuar autorit të vjershës në fjalë, poetit të madh Azem Shkreli, do të meritonte një “këngë të turpshme”, apo jo?!

**HEJZA:** Me ç’vëpër do të na kënaqë së fundmi Profesor Agim Vinca!

**VINCA:** Vitin e kaluar (2023) doli nga shtypi libri im “Jetë e vdekje përqafuluar. Ese & eulogji me një rragatë në fund”. Titulli është një varg i Lasgushit, kurse nëntitulli tregon përmbajtjen e librit. Ka dalë së fundmi libri “Antologji e Lirikës Shqipe të Dashurisë”, që, siç e thotë vetë titulli, është një antologji në të cilën janë përfshirë krijimet më përfaqësuese të poetëve shqiptarë që trajtojnë temën erotike, duke filluar nga krijimtaria e pasur gojore e deri te poetët (dhe poeteshat) e brezit më të ri. Kur m’u drejtova për intervistë para dy-tre muajve isha duke punuar intensivisht në këtë projekt, i cili tani është në duart e lexuesve.

Siç kam theksuar në parathënie, ideja për hartimin e kësaj antologjie më pat lindur shumë vjet më parë, teksa shfletoja “Librin e artë të Lirikës Botërore të Dashurisë” të një poeti dhe përkthyesi kroat, në të cilën nuk ishte përfshirë asnjë poet shqiptar dhe asnjë poezi shqipe! Gjithmonë kam qenë i ndjeshëm ndaj injorimit të vlerave të kulturës kombëtare, për çka nuk jemi pa faj as ne vetë, sepse për të hyrë në librat “e artë” të botës duhet t’i krijosh më parë librat e tu nëse jo “të artë” së paku “të argjendtë”.

**HEJZA:** Dhe, në fund fare, ndonjë mesazh për lexuesit e “Hejzës”?

**VINCA:** Gjurmoni të vërtetën dhe synoni hejzat e fjalës. E vlen të jetohet për të bukurën dhe të vërtetën, edhe atëherë kur ato rrezikohen nga shëmtia dhe gënjeshtria.



Pikëpamje

# PSE KULTURA SHQIPTARE DUHET TË NDRYSHOJË?

**Dhuna ndaj gruas që po e hasim me kaq frekuencë në kulturën shqiptare tregon që kultura shqiptare, me të gjitha institucionet e saja, është ngurtësuar, është fetishizuar, dhe si rrjedhojë ajo është dobësuar, ka humbur autoritetin dhe legjitimitetin e saj në mirëmbajtjen e detyrës së saj**

**Sead ZIMERI**

Nuk bëhet asnjë ndryshim kuptimplotë pa u ndryshuar nënvetëdija jonë kolektive. Nēnvetēdija nuk ndryshohet lehtë, pasi që ajo është një lloj rezervuari i ndjenjave, i mendimeve të padëshirueshme, që i kemi shtypur në mënyrë që të jetojmë një jetë sa më normale. Nēnvetēdija është rezervuari i instinktive, i lirisë së pakufishme, i dëshirës së pakontrolluar për pushtet. Qytetërimi dhe kultura kufizon, përmban dhe shtyp këto impulse dhe prijë që duan të dalin jashtë kontrollit të vetëdijes. Kjo anë e errët e njeriut nuk zhduket nga jeta jonë, por ajo shtypet, arrestohet, por njëkohësisht ajo vazhdimisht përpjehet t'i thyej prangat dhe zinxhërët që e mbajnë të shtypur. Nuk është lehtë aspak ta ndryshosh përmbytjen e nënvetëdijes, madje ndoshta një gjë e tillë është e pamundur. Psikologjia dhe psikoanaliza mund të na ndihmojnë që ta mbajmë më mirë nën kontroll, por as ato nuk mund ta ndryshojnë atë që e kemi shtypur tërë jetën tonë. Por ato mund të na ndihmojnë që ta vështrijmë dhe interpretojmë përmbytjen e saj në mënyrë që të jetojmë më lehtë, që ta pranojmë pa shumë rezistencë domosdoshmërinë e shtypjes së impulseve që kërcënojnë jetën shoqërore dhe kulturore. Kultura është mekanizëm që ndërmjetëson dhe ngre ura mes vetëdijes dhe nënvetëdijes. Shtypja e impulseve destruktive është e domosdoshme për sigurinë e tjetrit dhe mundësinë e bashkëjetesës në paqe. Njeriu mund të ketë lloj lloj dëshirash dhe impulse që në mungesë të kontrollit racional dhe kulturor do të shkaktonin rrëmujë dhe bënin kërde. Prandaj edhe duhet të ekzistojë një kontinuitet mes

racionalitetit individual dhe kontrollit shoqëror dhe kulturor. Kultura duhet të gjejë një ekuilibër të përshtatshëm mes përmbytjes së nevojave biologjike dhe përmbytjes së nevojave për bashkëjetesë.

Mirëmbajtja e këtij ekuilibri është çështje delikate, dhe nuk ekziston një mënyrë e vetme që i përgjigjet njeriut në çdo fazë të zhvillimit të tij. Prandaj kulturat janë të ndryshme dhe plurale. Ideja e një kulture të vetme është nonsense, absurditet. Detyrimisht do të ketë kultura të ndryshme, sepse secila kulturë bën përshtatjet e duhura për ta mbajtur këtë ekuilibër si konstantë mes vetëdijes dhe nënvetëdijes.

Por disa kultura ngurtësohen dhe e marrin veten për të shenjtë, duke i keqinterpretuar kështu ritet dhe zakonet si diçka që qëndrojnë përtej zhvillimeve historike dhe dinamikës mes vetëdijes dhe nënvetëdijes. Kultura kështu reifikohet, shenjtërohet, fetishizohet dhe, më në fund, ngurtësohet. Kur kultura shndërrohet në fetish ajo më nuk arrin ta kryejë detyrën e saj për të cilën ekziston, d.m.th. ndërmjetësimin mes impulseve për t'i thyer të gjitha tabutë dhe domosdoshmërisë për ta siguruar paqen dhe bashkëjetesën. Përkundrazi kur ajo bën presion më të madh apo më të vogël sesa është e domosdoshme për mirëmbajtjen e paqes dhe bashkëjetesës, ajo fillon ta luajë rolin e kundërt nga ajo që ajo duhet ta luajë dhe rrezikon paqen dhe bashkëjetesën. Ajo fillon ta turbullojë nënvetëdijen dhe ta humb kontrollin mbi të. Shtypja e madhe krijon rezistencë të madhe dhe shpërthime sporadike që minojnë paqen dhe bashkëjetesën. Shtypja e vogël krijon despotë që shtypin të tjerët e që po ashtu minon bashkëjetesën dhe paqen. Kultura shqiptare është kapur në paradoksin e shtypjes së madhe të

gruas dhe shtypjes së vogël të burrit.

Dhuna ndaj gruas që po e hasim me kaq frekuencë në kulturën shqiptare tregon që kultura shqiptare, me të gjitha institucionet e saja, është ngurtësuar, është fetishizuar, dhe si rrjedhojë ajo është dobësuar, ka humbur autoritetin dhe legjitimitetin e saj në mirëmbajtjen e detyrës së saj. Ajo më nuk është dinamike, por është mumifikuar si kufomë. Ne e nderojmë atë ashtu siç e nderojmë dhe respektojmë një kufomë, por njëkohësisht e mbajmë larg vetes, nuk duam ta marrim shumë seriozisht, sepse kufomat nuk e kanë vendin midis të gjallëve.

Kultura shqiptare është e pafuqishme prandaj edhe ajo në heshtje i toleron dhe pranon gjithë këto vrasje ndaj gruas. Ajo i toleron dhe pranon dhunën që shkaktohet nga burri i cili nuk ka gjetur në kulturën e tij mekanizmin mbrojtës kundër ndryshimeve që kanë ndodhur përreth tij. Gruaja ka liri më të madhe sot dhe fituar të drejta që ajo nuk i kishte më parë, dhe kjo ka shkakuar çarje në kulturën dhe nënvetëdijen kulturore shqiptare. Por pasi që kultura nuk ka ndryshuar bashkë me ndryshimet që kanë ndodhur përreth, ajo është dëshmuar e paaftë të ndërmjetësojë mes këtyre ndryshimeve. Burri ka mbetur me një kulturë të moçme, me një kulturë ku ai ishte zoti dhe gruaja shërbëtorja e tij. Por kur gruaja më nuk pranon të jetë shërbëtorja e tij, ai përdor mekanizmat që ai i ka në dispozicion për ta përforcuar rolin e tij tradicional. Në të kaluarën gruas i është dhënë më pak liri se burrit të saj, prandaj kur ajo merr më shumë liri kjo ia merr burrit privilegjet kulturore dhe e detyron t'i shtypë nën nënvetëdije privilegjet e tij të mëparshme. E bën të ndjehet më pak i lirë. Burrit nuk i konvenon që ta ndryshojë kulturën tradicionale.

Ja një shembull: më parë nuk ishte as problem juridik dhe as problem kulturor që burri ta disiplinonte gruan e tij përmes dhunës fizike, sikur që nuk ishte problem që ai ta përdhunonte atë në kurorë, sepse sapo ajo bëhej bashkëshorte ajo humbte të drejtën mbi trupin e saj. Trupi i saj bëhej pronë e burrit të saj dhe ai e shfrytëzonte atë ashtu siç ai e shihte të nevojshme. Kultura nuk e dënonte një veprim të këtillë, madje ajo e inkurajonte që burri të jetë burrë, dmth që burri ta ushtrojë pushtetin e tij të plotë mbi gruan e tij. Sa më shumë që ai ishte burrë, aq më i madh pushteti i tij mbi gruan e tij.

Ideali kulturor i burrit shqiptar është ideal që e bën gruan shërbëtoreshë, dhe i kërkon asaj respektimin dhe nënshtrimin ndaj burrit pavarësisht pozitës së tij në shoqëri. Koncepti apo ideali burrë është një nga konceptet me përmbytje më të dhunshme në kulturën shqiptare, prandaj ajo duhet të çlirohet nga ky bagazh kulturor. Kur i thua djalit bëhu burrë i mirë, këshilla jote në mënyrë implicite legjitimon dhunën ndaj gruas. Bëhu burrë i mirë do të thotë, bëhu ushtrues i mirë dhunës, kuptohet në të shumtën e rasteve simbolike, ndaj gruas tënde, mbaje atë nën kontroll të ngushtë dhe mos e lejo kurrë të kërkojë liri që përmbys privilegjet tua mbi të.

Ka ardhur koha që kultura shqiptare t'i lajë hesapet me të kaluarën e saj, të fillojë një proces të dhimbshëm të reflektimit mbi presupozimet e saj, ta kuptojë drejtë rolin e saj dhe të largohet nga fetishizimi i të kaluarës ngaqë tani për tani përveç dhunës fetishizimi i kulturës nuk solli asnjë mirë. Kultura duhet të zgjohet nga letargjia në të cilën ka rënë dhe të bëhet dinamike në mënyrë që ta kryejë detyrën e saj me përgjegjësi dhe integritet.



Gjurmëve të historisë

# FRANO MARK JAKOVA ME PESHËN E FILMIT "SKËNDERBEU.."

**Në vitin 1949 Shqipëria nuk kishte ende një Ministër Kulture, por kjo figurë e lartë institucionale përfaqësohej nga Drejtori i Përgjithshëm i Kulturës, detyrë me të cilën u ngarkua Frano Jakova. Pikërisht tim eti iu besua drejtimi i filmit "Skënderbeu - Luftëtar i Madh i Shqipërisë"**

**Përgatiti: Valbona JAKOVA**

Shumë herë kam dashur të kuptoj përse disa popuj janë më me fat se disa të tjerë. Në vija të përgjithshme, çdo individ, është në gjendje të japë një përgjigje mbi këtë argument pa hyrë në detaje filozofike. Është koha që zgjedh njeriun, është njeriu që zgjedh kohën apo është fati që i përmban këta faktorë?

Gjithashtu mund të themi se zgjedhjet, apo më mirë zgjedhja e çdo veprimi, si një akt vendimtar i pakthyeshem në çdo moment të jetës, ka një rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin e cilësisë shpirtërore e morale të secilit, pasi, në thelb, mbart një peshë të rëndësishme ndërgjegjësore. Dihet, fati i njeriut varet nga koha, nga epoka ku ai u gjind bashkë me të tjerë për të krijuar historinë përkatëse të asaj periudhe, për të hyrë në kujtesën historike të pasardhësve të tij, për të lënë gjurmë me bëmata e tij të mira. Këto gjurmë nuk humbasin kurrë pasi në çdo shoqëri ku mbizotëron një moral i shëndosh njerëzor, çdokush, përpara skandaleve dhe akteve me origjinë vëllavrasëse prej Kaini, nuk duhet dhe nuk mund t'i aprovojë ato në asnjë mënyrë. Këta trashëgimtarë të mbarsur me farën e Kainit, përgjatë historisë, janë mburrur më të shëmtuarën e ligësisë, kanë predominuar mbi masat me mënyrat më çnjerëzore të terrorit duke dashur të infektjnë dhe të influencojnë të lëkundurit, të dobët, të pangrënët, të paarsimuarit.

Sëmundja e diktatorëve, ka qenë dhe mbetet gjithmonë, egocentrizmi. Për ata, qendra e universit është gjithmonë uni, vetvetja, një bosht i tmerrshëm i rrotullimit marramendës, mjerues, pafundësisht i dhimbshëm për fatet e popujve. "Vrima e zezë e egocentrizmit është pa fund" (Philiph Roth). Pra në këtë greminë, në këtë humnerë, shtyhet të bjerë në një rënie gllabëruese me kthetra kafshërore, jeta njerëzore. Jetesa njerëzish sakrifikuar boshtit të pashmangshëm të një "Uni" të vetëm, hapësirë e zbratur zemre pa rrahje dhe shpirt. Përcaktimet në këtë drejtim janë pafundësisht të ndryshme sipas natyrës së dhimbjes që provon çdo njeri kur përballat me konsekuencat e ligësisë së padrejtësisë. Këto marrin formën dhe substancën më kuptimplotë kur ndeshen me të mirën fisnike, meditative, qetësuese pasi fatmirësisht ekzistojnë dhe altruistët, bamirësit, mësuesit e vlerave të fjalës së bukur.

Më ka vrarë gjithmonë ndërgjegjja që nuk kam bërë asgjë për memorien e prindërve të mi, ndoshta nuk ishte faji jonë pasi kemi jetuar gjithë jetën me terrorin e mosekzistencës së një të nesërmeje apo të ardhmes së pashpresë, përndjekjes gllabëruese që hap vetëm varre në shpirtin të pafajshëm.

Gjatë kohës së rritjes, brenda vetes, më vërshonin papushim mendime mbi jetën dhe botën rrethuese. Ne, të persekutuarit e regjimit, nuk kishim të drejtë të shkruanim. Familja jonë përbëhej nga katër vajza dhe dy djem. Unë isha e katërta dhe ndieja në mendjen time, furinë e



fjalëve që i drejttoheshin dikujt diku. Ishin biseda mbi drejtësinë dhe padrejtësinë. Ndodhesha në ndërtesa të papërcaktuara të imagjinatës adoleshente me njerëz të panjohur të njëfarë rangu. Akuzat ishin të përditshme, sikundërse të përditshme ishin edhe padrejtësitë. Njëra prej padrejtësive më të mëdha ishte fakti i internimeve pa fund, spostimeve nga njëri vend te tjetri me destinacion zonat më të egra dhe më të ftohta malore. Shtëpitë ku na sistemonin ishin të survejuara nga njerëz të posaçëm dhe nga aparate regjistrimi, gjë që ne të gjithë e dinim. Ishim të detyruar të mos jepnim mendim kudo që të ndodheshim dhe të mos flisnim. Prindërit kur kishin diçka për të komunikuar, dilyn jashtë dhe bënë një shëtitje.

Më kujtohet një ndodhi që tregonte xhaxhai im, Filip Jakova, që gjatë verës priste në shtëpinë e tij në Durrës, të gjithë nipërit dhe mbesat e tij me bujarinë e kryetarit të fisit. Në sjelljen e tij mbizotëronte një lloj fisnikërie e lindur, ndërsa fjalët e matura deri në përsosmëri, impononin respekt dhe autoritet. Kishte një lloj inteligjence matematike, por sikundërse ndodh me dhuntitë e pasura të mendjeve të ndritura, dispononte gjithashtu edhe aftësi shumë të mira letrare në fushën e përkthimit, të interpretimit analitik. Kishte prirje oratorie të spikatura me një sintezë gjykimi mjaft të drejtë dhe të paanshme.

Kështu, kur ishim mbledhur te ai, na tregoi një episod kur ishte sëmurur në burg dhe e kishin shtruar në spital. I kishin dhënë leje Arsinoit, gruas së tij, ta vizitonte. Poshtë shtratit i kishin vënë një regjistruer zëri. Duke e ditur një gjë të tillë, sapo hyn e shoqja, i bën me shenjë praninë e aparatit. Hyn në dhomë një infermiere që pasi lajmëroi mbarimin e afatit të takimit, ngriti nga shtrati xhaxhain dhe menjëherë rrëmben komplet dyshekun bashkë me aparatin regjistruer të asaj kohe. Kjo natyrisht, ishte një skenë tragjiko-komike, pasi infermierja e turnit që kuronte xhaxhin, nuk donte që pacienti të ndërronte shtrat, si përfundim nisi një grindje mes tyre dhe të dyja u përlëshën në një mënyrë komike derisa me në fund, ajo që ishte aty me mision, ulëriu duke thënë: kam urdhër nga lart!

Njeri guximtar dhe siç ndodhë në përgjithësi me shkodranët, kur rrëfejnë një ngjarje, e bëjnë për dy arsye me të njëjtën peshë: e para për t'i dhënë kënaqësi dëgjuesit, e dyta, për t'i thënë kujdes, udhët e jetës janë të mbushura me kurthe.

Im at, Frano Jakova, pas luftës, punoi në detyra të ndryshme. Punonte në Kontrollin e Shtetit para se ta emëronin Sekretar i dytë i Ambasadës Shqiptare në Moskë. Në këtë periudhë, pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, erdhi në Moskë vëllai i tij, Filipi, për të vazhduar studimet universitare të filluara në Universitetin e Zagrebit. Në vitin 1951, ai u diplomua në Bashkimin Sovjetik, Moskë, për Ekonomi, dega plan, me rezultate të larta, duke u cilësuar njëri nga katër studentët më të mirë të kursit. Emërohet në Ministrinë e Tregtisë së Jashtme në detyrën e zëvendësministrit, funksion që e mbajti deri në vitin 1955, kur ndodhi goditja e Tukut.

Vëllezërit nuk mundën të kalonin bashkë një kohë të gjatë pasi po atë vit, tim eti i erdhi urdhri të kthehej. Natyrisht, i përkisnin një rang të lartë politik dhe pozicione të tilla pune, ofrojnë mundësi të bukura jetese.

Në Moskë, tre motrat e mia shkonin në kopshte javore. Unë nuk kisha lindur aso kohe. Prindërit kishin leje të shkonin dhe t'i takonin gjatë javës. Si diplomat i Ambasadës Shqiptare, ishte njohës i mirë i gjuhës ruse dhe në prani të kujdestareve ruse, duhej të flisnin rusisht. Ndodhte që motrat, me rusishten e tyre të vlin në një pozicion të vështirë veçanërisht mamanë, në raste të tilla ndërhynte im at duke gjetur formulën më të përshtatshme për ta nxjerrë nga situata. Në fakt, si fillim në Moskë shkoi im at pa familjen, pasi mamaja ishte në pritje të motrës së tretë. Pas lindjes, ajo dhe tre motrat, do të shkonin në Odesë me anije dhe prej aty në Moskë, me avion.

Im at qëndroi në Moskë katër vite, nga 1949 deri më 1951. Pikërisht në vitin 1949, një delegacion i Qeverisë Shqiptare me në krye Enver Hoxhën, do të shkonte në Moskë për t'i kërkuar Qeverisë së BRSS një bashkëpunim midis kinematografisë shqiptare dhe asaj ruse mbi Skënderbeun, heroin tonë legjendar!

Në atë kohë, Shqipëria nuk kishte ende një Ministër Kulture, por kjo figurë e lartë institucionale përfaqësohej nga Drejtori i Përgjithshëm i Kulturës, detyrë me të cilën u ngarkua Frano Jakova. Pikërisht tim eti iu besua drejtimi i filmit "Skënderbeu - Luftëtar i Madh i Shqipërisë"

...Filmi "Skënderbeu- Luftëtar i madh i Shqipërisë", për herë të parë në vendin tonë, u shfaq në Qytetin "Stalin", ku ekzistonte një lagje e tërë me specialistë sovjetikë, që punonin në fushën e naftës, në prodhim dhe në institute studimore. Thuhet se kanë qenë rreth 350 familje sovjetike... 1

Fatkeqësisht sot nuk flitet më për këtë film që u shfaq, "më 3 prill 1954 në Kanë ku u zhvillua Festivali 7 Ndërkombëtar i filmit." Filmi "Skënderbeu" në Festivalin e Kanës pati sukses dhe u shfaq më 26 mars. Vetëm delegacioni italian iku nga salla. Çmimi i madh iu dha filmit japonez "Porta e ferrit". "Skënderbeu" dhe disa filma të tjerë morën çmimin Internacional. Ai mori çmimin e parë si regjisorë, Jutkeviçi, dhe çmimin e parë teknik nga komisioni i lartë teknik i kinemasë përsa i takon ngjyrave. Përpara fillimit të festivalit, ambasada turke në Paris kishte protestuar pranë jurisë që filmi mos të shfaqej. Jehona e tij ishte e madhe. Tri shoqëri franceze kanë kërkuar 40 ose 50 kopje që të shfaqet filmi në Francë, dublazh frëngjisht. Italia kërkon ta blejë me kusht që të bëhen disa shkurtime".

Duke jetuar sot në Itali, mendoj se do të ishte diçka me vlerë të flisnim edhe për të kaluarën. Të tregosh për figurat e mëdha, është detyrë patriotike e çdo atdhetari. Një hero legjendar si Gjergj Kastrioti Skënderbeu ka hyrë dhe mbetur në historinë e vendit tonë dhe jo vetëm, për vetitë e tij të rralla prej strategu me mendje dhe forcë thuajse mbinjerëzore. Në fakt nuk ka vdekur, e gjejmë jo vetëm si emër, por edhe si bust të vendosur me shumë krenari në të gjitha krahinat e Italisë ku jetojnë arbëreshë. Filmi është mishërimi i kujtesës, i memorieve jetuese lehtësisht nga një brez te tjetri. Na tregojnë se nga vijnë për të kuptuar më mirë se në ç'drejtim duhet të shkojmë. Kinematografia ka avantazhin të tregojë shumë më tepër. Skenat e një filmi ngulisin në memorie fakte të pashlyera të popullit tonë, pasi filmi është autobiografik dhe si i tillë zhvillon ngjarjet e asaj kohe. Pra filmi ka si detyrë të përfaqësojë kohën dhe të ringjallë njeriun, vlerat, përmes personazhit.

Më 24 prill 1954, Presidiumi i Kuvendit Popullor dekretoi kolektivin që mori pjesë në realizimin e filmit "Skënderbeu, luftëtar i madh i Shqipërisë". Midis tyre me Urdhrin e Punës së Klasit II: Frano Mark Jakova.

Im at u nda nga ne në vitin 1994. Ai na la kujtimin e shumë dekoratave të tij, të cilat i ruante si një thesar të çmuar bashkë me fotografitë e filmit të cilin pati fatin ta drejtonte dhe të ishte i pranishëm gjatë zhvillimit të skenave të realizuara në Shqipëri, shpesh duka na treguar edhe episode dhe ngjarje rreth xhirimit...

Shkrimtarët, këta “armiqtë të popullit”

# PËRJASHTIMI NGA “HISTORIA E LETËRSISË”

**Raste tipike të këtij lloji dënimi i gjejmë në përjashtimin e veprës së Gjergj Fishtës, Faik Konicës e Ernest Koliqit, fshirja e të cilëve, ku plotësisht e ku cekur përciptazi, aq sa meritonin të lakoheshin armiqtë, solli dëm të tejskajshëm në hierarkinë letrare**

## Brunilda PRIFTI

Tekstet e historive të letërsisë shqipe janë pasqyra më e mirë e dënimit me përjashtim të një numri jo të paktë shkrimtarësh e poetësh, të shpallur si “armiqtë të popullit”, jo për shkak të veprës së tyre letrare, por për shkak të angazhimit të tyre politik. Ky përjashtim nga tekstet e historisë së letërsisë ka shërbyer si një dënim propavajtes për një grup autorësh, vepra letrare e të cilëve është krijuar përpara vendosjes së regjimit komunist dhe kanonizimit të realizmit socialist në letërsi e arte. Raste tipike të këtij lloji dënimi i gjejmë në përjashtimin e veprës së Gjergj Fishtës, Faik Konicës e Ernest Koliqit, fshirja e të cilëve, ku plotësisht e ku cekur përciptazi, aq sa meritonin të lakoheshin armiqtë, solli dëm të tejskajshëm në hierarkinë letrare. Dy të parët nuk jetuan aq sa ta merrnin për së gjalli këtë dënim, ndërsa Koliqi e ka vuajtur shumë këtë ndërprerje komunikimi me lexuesin e tij shqiptar, që nga Roma, ku jetoi deri sa vdiq, me damkën e “fashistit” dhe “armikut të popullit”.

Për të kuptuar më mirë se si u trajtuan këto figura dhe vepra e tyre nga institucionet zyrtare studimore e akademike, të cilat me hir apo pahir u vunë në shërbim të propagandës së kohës, na vjen në ndihmë një qasje krahasimore mes tre tekstesh të “Historisë së letërsisë shqipe”, dy të botuara dhe prej nga gjeneruan të gjitha tekstet shkollore të letërsisë, ndërsa një i mbetur në tentativë, bocet, si një përpjekje për të “rehabilituar” emra si Fishta apo Konica.

Flasim konkretisht për tekstin “Historia e letërsisë shqipe 2” e vitit 1959, hartuar

nga Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë; “Historia e letërsisë shqiptare: Që nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare”, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1983; Historia e Letërsisë Shqipe e viteve 1912-1939, bocet i çuar për botim në vitin 1968, hartuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës, që gjendet në Arkivin e Institutit të Letërsisë.

Historia e letërsisë shqipe në rrugëtimin e saj, fill pas ndryshimeve që pasuan në vitet ‘44-‘45 e deri në botimin e 1983-shit, nuk mundi dot t’i shkiste kufizimeve ideologjike, as kufirit të vënë: ‘me ne, ose kundër nesh’. Mjafton të kujtojmë deklaratën e Shefqet Musarajt gjatë fjalës në Konferencën e III të Lidhjes së Shkrimtarëve, në tetor 1949, për të kuptuar drejtimin që do të merrte letërsia, edhe pse sinjalet ishin dhënë së paku 3 vite më parë: “Po mundet që në mes t’onë të ketë shkrimtarë që të mos jenë për këtë udhë. Ne jemi të detyruar t’u shpjegojmë këtyre udhën e drejtë. Në qoftë se me gjithë përpjekjen tonë, s’do mund të kuptojnë ose do të bëjnë sikur s’kuptojnë...të jenë të sigurt se puna ose lufta jonë do t’i eliminojë”. “Historia e letërsisë shqipe”, botuar në dy vëllime më 1959, paraprihet nga një botim i vitit ‘55, pak më bujar me autorët, që më pas do të ndëshkoheshin. Shuteriqi, kryeredaktor i këtij botimi, edhe i të tjerëve që do të pasonin e ‘justifikon’ këtë me urdhrin me shkrim të vitit 1946 për heqjen nga teksti i letërsisë të disa shkrimtarëve, mes tyre Fishta, Konica, Koliqi etj. Për këtë kishte folur qartë Enver Hoxha, disa muaj para se të zhvillohej Konferenca III e Lidhjes, teksa urdhëronte prerë: “Të mos merremi me

diskutime boshe për autorë reaksionarë si Fishta, Koliqi etj. ...”

Prej kohës kur At Gjergj Fishta u shpall “reaksionar” në Konferencën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, në vitin 1949, trajtimi i tij në tekstet e “Historisë së letërsisë shqipe” ka pësuar oscilacione. Herë qëndrimi ndaj tij është tepër i ashpër dhe përjashtues, herë më tolerant dhe me tendencë përfshirjeje. Nëse do të krahasojmë tri tekste, dy zyrtarë dhe një i mbetur në bocet, do të vëmë re pikërisht këtë dukuri. Në tekstin e vitit 1959, hartuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, qëndrimi përjashtues ndaj Fishtës nuk lë shteg për nënkuptime. Edhe pse ai renditet si një ndër emrat më të rëndësishëm të kohës së vet, vepra e tij nuk bëhet objekt studimi. Në tekstin, që nuk e pa dritën e botimit, të vitit 1968 shohim një tentativë të qartë për ta rehabilituar figurën e Fishtës. Ndonëse autorët nuk harrojnë t’i përshtaten ideologjisë së kohës, duke mos ia kursyer epitetin “reaksionar”, vepra e tij merret në analizë dhe vihen në dukje gjithë vlerat e tij në lëmnë të krijimtarisë, publicistikës, përdorimit të gjuhës, referimit ndaj folklorit, etj. Qëndrimi më radikal për të është ai në tekstin e “Historisë së letërsisë” së vitit 1983, ku emri i Fishtës përmendet vetëm si kundërpeshë për të ngritur imazhin e një figure tjetër të kohës së tij.


Të kursyer ndaj Fishtës janë treguar autorët e “Historisë së letërsisë” së vitit 1959. Në këtë tekst emri i tij vetëm përmendet tek-tuk, si pjesë e zhvillimeve letrare të kohës. Emrit të Fishtës, tek përmendet në radhën e “personaliteteve të fuqishme letrare”,

nuk i kursehet etiketimi si “reaksionar”, por në këtë tekst do lexojmë të njëjtat ngjyresa negative dhe denigruese, që do t’i gjejmë me shumicë në një tekst të gati 25 viteve më vonë. Në tekstin e ‘59-ës, Fishta renditet ndër emrat më të rëndësishëm të kohës:

“Është koha kur në letërsinë shqipe po duken disa personalitete të fuqishme letrare që lozin, kush më shumë e kush më pak një rol të dukshëm gjatë rilindjes, që po e ushtrojnë veprimtarinë e tyre të gjerë edhe në kohën e pavarësisë si Konica, Sqiroi, Fishta, Noli”.

Pavarësisht se qëndrimi ndaj Fishtës ishte i qartë, si pjesë e klerit katolik, që përkrahu pushtimin fashist të Shqipërisë, nuk i mohohet kontributi në letërsi dhe publicistikën e viteve të fundit të shekullit të XIX dhe fillim të XX. Gjithnjë në dyzimin mes trajtimit të figurës së Fishtës sipas ideologjisë së kohës apo si një figurë e rëndësishme në letrat shqipe, herë-herë aktiviteti i tij apo i të tjera figurave të “përfshiuara” nga letërsia shqipe, kufizohet vetëm në disa interesa të ngushta lëvrimi, duke vënë në dukje dhe qëndrimet e tyre politike.

“Një tjetër shkrimtar, Fishta lidhej edhe ai pas politikës austriake. Idetë e Rilindjes ndër këta shkrimtarë kufizoheshin më shumë te puna kulturore, botimi i librave, përpunimi i gjuhës, zhvillimi i letërsisë. Kur ishte fjala për zhvillimin shoqëror të vendit... Konica merrte shpesh anën e feudalëve dhe të parësisë, Fishta dhe Sqiroi himnizonin, njëri jetën patriarkale të malësive të prapambetura, tjetri dyert feudale më reaksionare, apo me fashizmin italian.



*Nga Arkivi*

# KULTURA DHE PROPAGANDA MANIPULUESE SOC-REALISTE

**Gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, sidomos pas vitit 1970, politika gjuhësore kishte një ndikim të madh në formimin e identitetit kombëtar dhe kulturor, sidomos në kontekstin e Kosovës, ku ndikimet nga Shqipëria ishin të pranishme dhe të forta**

**Nga Avni Halimi**

Gjatë regjimit diktatorial të Enver Hoxhës, asgjë nuk lihej rastësisht dhe çdo aspekt i jetës publike ishte i rregulluar nga shteti dhe ideologjia socialiste. Në këtë kontekst, politika shtetërore shqiptare, përfshirë propagandën për Kosovën, ishte e bazuar në një qasje të kujdesshme dhe të mirëplanifikuar. Propaganda për Kosovën në Shqipërinë socialiste ishte një instrument i rëndësishëm politik dhe ideologjik, që shërbente për të promovuar një imazh të kontrolluar të realitetit kosovar, të përshtatur me interesat e regjimit të Hoxhës dhe për të mbështetur projektin e tij për një Shqipëri të izoluar dhe të vetë-mjaftueshme. Kjo vërehet edhe në dokumentin e arkivuar në Arkivin Shtetëror, i cili ka të bëjë me PLANET TEMATIKE TË ORGANEVE TË SHTYPIT, RADIOTELEVISIONIT DHE SHTËPIVE BOTUESE LIDHUR ME PROPAGANDËN PËR KOSOVËN.

**Kur vëllai bëhej "shok i idealit socialist"**

Në fakt, nëse analizohet me kujdes tërë kjo "strategji propagandistike" do të vërehet se regjimi enverist më së paku interesohej për propagandim të çështjes së Kosovës. Përmes kësaj "propagande" në fakt, regjimi, mendohej të nënvizojë të gjitha ato angazhime kombëtare të dështuara ndër vite e dekada, derisa do të vije socializmi, i cili duhet të konceptohet si e vetmja ideologji kombëtare "me vlera të pavdekshme".

Në arkivat shtetërore të Shqipërisë komuniste, dokumentet (pra, edhe dokumenti në fjalë) tregojnë një përdorim të qëllimshëm të termave si "kosovarët," "shoqëria kosovare," "shtypi kosovar," "letërsia kosovare," "trashëgimia popullore kosovare," "arkeologjia kosovare" etj. në vend të referimeve më të përgjithshme si "shqiptarët e Kosovës," "letërsia shqiptare e Kosovës," "trashëgimia kulturore e shqiptarëve të Kosovës" etj. Kjo zgjedhje e gjuhës nuk ishte e rastësishme. Duke përdorur këto terma, regjimi synonte të ndërtonte një identitet të veçantë për shqiptarët e Kosovës, një identitet që do t'i shërbente narrativës së regjimit për ta trajtuar Kosovën si një çështje të jashtme, të distancuar nga vetë kombi shqiptar. Kjo ishte në përputhje me strategjinë e Hoxhës për të shmangur përplasjet e hapura me Jugosllavinë, sidomos pas ndarjes me Jugosllavinë e Titos në vitin 1948.

Pas Luftës së Dytë Botërore, marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishin komplekse dhe të ndryshueshme. Fillimisht, Tito dhe Hoxha kishin një aleancë të përkohshme bazuar në ideologjinë e përbashkët komuniste. Në këtë kontekst, shqiptarët e Kosovës u paraqitën nga propaganda shqiptare si "shokë të idealit socialist," dhe shpesh, përkujtimi i figurave historike të Luftës së Dytë Botërore nga Kosova fokusohej vetëm tek ata që kishin kontribuar në luftën antifashiste. Nuk përkujtohet asnjë ngjarje nacionaliste e shqiptarëve të Kosovës, asnjë personalitet nacionalist shqiptar, nuk preferohet të përkujtohen me asnjë fjali as demonstratat dhe represionet komuniste antishqiptare pas ngjarjeve të vitit 1968 etj. Pra, shqiptarët e Kosovës kujtoheshin vetëm si kontribuues në luftën antifashiste, të tjerët sikur nuk ishin shqiptarë për regjimin e Hoxhës! Kjo qasje ishte një mënyrë për të afirmuar legjitimitetin e regjimit në Shqipëri dhe



për të portretizuar luftën antifashiste si një çështje mbarëshqiptare, por gjithmonë në frymën e socializmit dhe të ndihmës reciproke mes popujve "të barabartë" të Ballkanit. Pasi marrëdhëniet mes Hoxhës dhe Titos u përkeqësuan, propaganda shqiptare ndryshoi ton, duke kritikuar regjimin jugosllav për shtypjen e shqiptarëve të Kosovës, por gjithmonë duke e ruajtur një distancë të kujdesshme retorike për të mos e përfshirë hapur çështjen kosovare si pjesë të çështjes kombëtare shqiptare.

**"Kosovarët" dhe diferencimi i identitetit kombëtar**

Përdorimi i vazhdueshëm i termave si "kosovarët," "krijuesit kosovarë" në vend të "shqiptarëve të Kosovës" tregon një përpjekje të ndërjegjshme për të krijuar një identitet të veçantë për shqiptarët e Kosovës, të ndarë nga shqiptarët e Shqipërisë. Kjo kishte disa qëllime strategjike: e para, në një periudhë kur Ballkani ishte një arenë e ndjeshme gjeopolitike, Enver Hoxha nuk donte të provokonte Jugosllavinë duke e paraqitur Kosovën si një pjesë të pandarë të kombit shqiptar. Krijimi i një identiteti "kosovar" ndihmonte në zbutjen e tensioneve dhe e mbante çështjen brenda kufijve të Jugosllavisë socialiste; e dyta, duke e paraqitur çështjen kosovare si një problem që lidhej me zhvillimin socialist të popujve të Jugosllavisë, Hoxha synonte të krijonte një perceptim ku regjimi i tij paraqitej si mbrojtësi i interesave të "shokëve kosovarë," por pa e sfiduar hapur integritetin territorial të Jugosllavisë. Kjo qasje lejonte Hoxhën të ruante legjitimitetin e tij si lider i lëvizjes socialiste shqiptare pa rrezikuar përplasjet ndërkombëtare; e treta, duke përdorur terma të veçantë për shqiptarët e Kosovës, propaganda krijoi një formë të nacionalizmit ideologjik, ku mbrojtja e të drejtave të kosovarëve bëhej pjesë e projektit socialist, e jo një çështje kombëtare shqiptare. Kjo strategji shmangte rrezikun e nacionalizmit të papërmbytur, që mund të kërcëronte stabilitetin e regjimit totalitar.

Një element i rëndësishëm i propagandës së regjimit enverist ishte promovimi i "letërsisë kosovare" dhe "krijuesve kosovarë." Kjo kishte për qëllim të theksonte se shqiptarët e Kosovës kishin një kulturë të zhvilluar dhe të respektuar brenda Jugosllavisë, por gjithashtu se kjo kulturë ishte pjesë e një identiteti të veçantë kosovar, e jo thjesht një zgjatim i kulturës shqiptare. Autorët dhe krijuesit që afirmoheshin në Shqipëri ishin ata që

përputheshin me ideologjinë komuniste, që kishin kontribuar në luftën antifashiste, ose që shkruanin në frymën e socializmit. Kjo shërbente për të përfunduar narrativën se shqiptarët e Kosovës ishin pjesë e një projekti të përbashkët socialist, në përputhje me vizionin e regjimit shqiptar për bashkim popujsh të "barabartë" në luftën kundër imperializmit.

Kjo qasje propagandistike ka lënë një trashëgimi të thellë dhe të ndërlikuar në mënyrën se si shqiptarët e Kosovës janë perceptuar në Shqipëri dhe në mënyrën se si ata kanë zhvilluar identitetin e tyre. Ndërkohë që sot përdorimi i termave si "kosovarët" është më pak i ngarkuar politikisht, ai ende reflekton ndarjen e krijuar gjatë periudhës komuniste. Regjimi i Hoxhës jo vetëm që e krijoi këtë ndarje për arsye taktike, por edhe e përfundoi atë përmes mjeteve të propagandës kulturore dhe ideologjike, duke e lënë pas një trashëgimi komplekse të një identiteti të veçantë "kosovar," të ndarë nga identiteti kombëtar shqiptar.

Dokumenti për të cilin do të shkruhet në disa vazhdimet e që bën fjalë për një propagandë socialiste për Kosovën, shihet se është një projekt kompleks dhe i mirëplanifikuar, që shërbente si një mjet për të përfunduar legjitimitetin e regjimit të Hoxhës, për të kontrolluar narrativën kombëtare dhe për të manovruar me kujdes brenda mjedisit të ndërlikuar politik të Ballkanit. Kjo propagandë na del si një pasqyrë e politikave të ndjekura nga regjimi, të cilat nuk ishin kurrë spontane apo të paplanifikuara, por gjithmonë pjesë e një strategjie të qëllimshme për mbrojtjen e interesave të pushtetit totalitar.

**"Propaganda matematikore" që e madhëronte regjimin totalitar**

Rëndësia e këtij dokumenti konsiston vetëm në katalogizimin e një sërë ngjarjesh e shkrimesh të publikuara në organe të ndryshme e që mund të shërbejnë për studiues të rinj. Për vitin 1979 vendoset që në kuadër të gazetës "Zëri i Popullit" të botohen 32 shkrime, gjegjësisht në çdo ditën e dhjetë të përkujtohet nga një ngjarje. Shumica e shkrimeve që do të botohen nuk dihet se prej nga merren dhe kush janë autorët e tyre. Në këtë organ planifikohen që gjatë këtij viti të botohen këta shkrime: Komiteti i "Mbrojtja kombëtare e Kosovës" (formuar me 7 nëntor 1918), "Kongresi i manastirit" (14-22 nëntor 1098), "Shqiptarët dhe beteja e Kosovës e vitit 1389), "Kryengritja antiosmane e

Prizrenit 1839), "Kryengritja antiosmane e Kosovës dhe Malësisë së Veriut në fund t shekullit XVII", "Kryengritja antiosmane e Kosovës e vitit 1844", "Fillimi i luftës për mbrojtjen e Plavës dhe Gucisë (tetor 1879)", "Lëvizja për gjykatat shqiptare në Kosovë më 1879", "Lidhja e Pejës, 1899", "Lidhja e Pejës në gazetën "Shqipëria" dhe në memorandumet e Shoqërisë Shqiptare të Bukureshtit", "Mbledhja popullore e Ferizajt më 1909", "Kryengritja antiosmane e Kosovës 1910", "Kryengritja antiosmane e Kosovës 1912", "Lufta ballkanike dhe Shqipëria", "Mbi vendimet antishqiptare imperialiste për copëtimin e Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1013", "Bajram Curri dhe kontributi i popullit të Kosovës në Revolucionin e Qershorit 1924", "Çlirimi i Tuzit" (2 dhjetor 1944), "Çlirimi i Podgoricës" (18 dhjetor 1944), "Demonstrata antifashiste e Gjakovës e 8 dhe 28 nëntorit 1941" etj.

Ndërkaq, në kuadër të përkujtimit të figurave historike të Lidhjes së Prizrenit dhe të figurave të tjera të shquara do të botohen 17 shkrime dhe, konkretisht, për këta figura: Ahmet Koronica, Ali Dervish Prishtina, Ali Ibra, Binak Alia, Col Delia, Iljaz Pashë Dibra, Jakup Feerri, Mic Sokoli, Sheh Mustafa Tetova, Sef Kosharja, Sulejman Vokshi, Ymer Prizreni, Zija Prishtina etj. Nga figurat e shquara do të botohen artikuj mbi Ismail Qemalin dhe Isa Boletinin, Shotë dhe Azem Galicën, Ali Kelmendin, Asim Vokshin, Xhevdet Dodën, Hajdar Dushin, Mustafa Bakiun, Emin Durakun, Sadik Stavilecin etj.

Në "Zërin e Popullit", në fushën e letërsisë dhe kulturës "Plani tematik" parasheh të botohen lajme kulturore nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia. Pastaj, reportazhe mbi aktivitetin e shoqërive kulturore në Kosovë, Turqi dhe Kalabri, përshkrime letrare për qytetet dhe Muzetë e Kosovës, mbi bibliotekat e Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë, artikuj, siç thotë "Plani tematik", "mbi unitetin historiko-kulturor, që të tregojmë se kemi luftuar bashkë, në një truall, me një gjuhë, se kemi të njëjtat tradita", artikuj mbi letërsinë kosovare.

Ndërkaq, ky "plan tematik" propagandën për Kosovën në gazetën "Puna" e ka paraparë përmes këtyre botimeve: "Memorandumi i Lidhjes së Prizrenit për bashkimin e pesë vilajeteve (1878-1879)", "Besëlidhja e Pejës dhe Haxhi Zeka (1897 dhe janar 1899)", "Lufta për arsimin shqip dhe përpjekjet e Hasan Prishtinës (1909)", "Kaçaniku, Cërnavë dhe trimi legjendar Idriz Seferi (1910)", "Kosova në luftën për pavarësimin e Atdheut 1912", "Juniku - vendi ku lidhej vbesa shqiptare 1912", "Vera e vitit 1919 në Kosovë", "Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe programi i përgjithshëm për veprimtarinë e kryengritjes 1919", "Gratë kosovare në luftë për liri dhe pavarësi", Gazeta "Populli" organ i Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" dhe roli i tij, "Klubi pansllavist i Beogradit dhe politika e tij për shkombëtarizimin e Kosovës etj. Gjithashtu planifikohen të botohen edhe shkrimet që do të ndriçojnë figurën patriotike të: Ymer Paçarizit, Emin Durakut, Hajdar Dushit, Xhevdet Dodës, Ibe Palikuqit etj, Kurse, në kuadër të rubrikës temat e ditës do të botohen shkrimet: "Çiftelia dhe këngët në odat kosovare", "Tema e punës në poezinë e popullit", "Përshkrime historike-geografike të "Fushës së Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit, Rugovës, Drenicës, Podujevës, Karadakut etj.

(vazhdon)

Qasje

# MNEMOZINA E TOPIKËVE TË TRISHTË LETRAR

**Letërsia e këtyre "topikëve të trishtë" është lehtësisht e evidentueshme. Mjafton t'i qasemi secilit topos ku vuajtën autorët e dënuar politikisht, për të hartuar mandej një repertor të pasur e të larmishëm tekstesh e veprash**



## Agron TUFA

Burgjet, kamp-burgjet, kampet "me tela me gjemba" dhe kampet e zakonshme të internimit me punë të detyrueshme, përbëjnë, përveçse topografi të dhimbjes e terrorit, edhe një topikë të trishtë të shkrimit në letrat shqipe. Zhanret e shkrimit janë të larmishme; ato prekin romanin, tregimin, poezinë, kinematografinë, përkthimin artistik e shkencor, poezinë dhe memuaristikën, deri dhe disa lloje të pikturës e skulpturës (gdhendje të ndryshme, statueta, punime të holla artistike etj).

Prania e kësaj topike të trishtë burgjesh e kampesh nuk e ka pushuar jehonën e vet traumatike edhe sot e kësaj dite, ndonëse që nga viti 1991 kur ato u mbyllën dhe u braktisën, kanë kaluar mbi një çerek shekulli. Realet e këtyre "kronotopeve" ushqejnë ende vepra letrare e narrativa memuaristike. Disa piktorë si Maks Velo, Ali Oseku, e sidomos Valer Dyrzi vazhdojnë t'i kthejnë jehonën e transfiguar artistikisht përjetimeve nga kjo topografi makthesh. Narrativa letrare, e drejtpërdrejtë apo fiktion na i sjell këto vende me një metonimi diskursi alegorik, simbolik apo filozofik, si në veprat e Kasëm Trebeshinës ("Odin Modvalsen"), Makensen Bungo (romani "Kënetë e vdekjes" dhe memualet), Pjetër Arbnori "Vdekja e Gëbelsit" dhe memualet), Petro Marko ("Retë dhe gurët"), Jamarbër Markos (poezitë), Fatos Lubonjës ("Ridënimi"), Henrik S.G (romani Metamorfoza e brezit të humbur", "Gjuetia e pëllumbave"), Bashkim Shehut ("Angelus Novus", "Loja, shembja e qiellit" dhe një varg romanesh), Visar Zhitit (poezitë "Hedh një kafkë në këmbët tuaja", memuaristika, etj).

Letërsia e këtyre "topikëve të trishtë" është lehtësisht e evidentueshme. Mjafton t'i qasemi secilit topos ku vuajtën autorët e dënuar politikisht, për të hartuar mandej një repertor të pasur e të larmishëm tekstesh e veprash.

Nëse studimet letrare-kritike shqiptare apo studimet sociologjike letrare do ta kishin marrë në konsideratë faktologjinë e këtij shkrimi, të cilin me të drejtë poeti Visar Zhiti e quan "Burgologji", atëherë do të na përftoheshin korpuse të veçanta, blloqe tekstesh e narrativash në repertorin e gjerë të "burgologjisë". Kështu do të dallonim qartë "tekstet e Burrelit", "tekstet e Tepelenës", "tekstet e Kënetës së Maliqit",

"tekstet e Spaçit dhe Qaf-barit", etj, et..

Herëdokur studiuesit e kësaj fushe që do të merren me fenomenologjinë e këtyre teksteve, do të prekin vërtetësinë simbolike të titullit të mësipërm: "Topikë të trishtë letrare". Të trishtë këto tekste i bën jo aq topika si vend vuajtje e torture, por nonsens, paradoksi dhe absurdi i fatit të vuajtësve, të cilët ishin qenie me rrënjë të thella në dije dhe kulturë, përkundër nivelit katastrofik të xhelatëve të tyre. Në njëfarë mase persekutimi komunist mbi këta njerëz, që ishin, pa asnjë fije dyshimi, elita e kulturës shqiptare, ajka e inteligjencës, njerëzit më të ditur e të shkolluar të Shqipërisë së pasluftës. Mjafton të përmendim disa syresh: Petro e Jamarbër Marko, Astrit Delvina, Arshi Pipa, Mitrush Kuteli, At Zef Pllumi, Sami Repishti, Kasëm Trebeshina, Mustafa Greblleshi, At Konrad Gjolaj, Ejell Çoba, Makensen Bungo, Uran Kalakulla, Guljelm Deda, Havzi Nela, Pjetër Arbnori, Lekë Previzi, Lekë Tasi, Fatos Lubonja, Visar Zhiti, Bashkim Shehu etj. Veprat e tyre ilustrojnë një kronotopi të fatit të intelektualit në diktaturë dhe janë i vetmi repertor i moralshëm i shkrimit që rivendos dinjitetin e raporteve me të Vërtetën, një raport, i cili, jashtë këtij kronotopi, ishte përkeqësuar, fshehur, deformuar e shfityruar nga censura dhe autocensura komuniste.

Termi "Kronotopos" për këtë korpus tekstesh nuk e ka këtu funksionin e nocionit estetik bahtinian, pasi ai nuk zbatohet në botën e trillit artistik. Ai thjesht ndodh dhe lind brenda një realeje konkrete kohë-hapësinore, aty ku është e mbërthyer në kryq ekzistenca, mbijetesë e autorit që përpiqet të ruajë fizionominë e vet njerëzore.

Një ndër këto kronotope, që ka determinuar lindjen e një repertori të veçantë tekstesh letrare në prozë, poezi, memuaristike, kinematografi e, madje, edhe në zhanret kronikale ideologjike të historisë zyrtare, sikundërse dhe të shkrimit diplomatik, është Kënetë e Maliqit me kampin famëkeq të Vloçishtit përgjatë periudhës 1946-1950. Kënetë e Maliqit është njëmend, jo vetëm "topikë e trishtë" letrare. Tekstet që ka prodhuar ky topos janë kundërtëne dhe diametralisht të kundërta. Nga njëra anë kemi tekste autoriale intencionalisht ideologjike, propagandistike, manipuluese në raport me të Vërtetën dhe, nga ana tjetër, kemi tekste autoriale autobiografike, që

këmbëngulin në raportet dëshmuese me të Vërtetën tronditëse.

Në këtë kundëvënie spikasin më fort tekstet letrare konfrontuese në gjininë e romanit. Përkatesisht kemi:

Fatmir Gjata me romanin "Kënetë". Romani qe pjesë e srz (seria e romanit të zgjedhur), deri në vitin 1991; ishte një vepër letrare e programuar me detyrim në kurrikulat shkollorë/universitare, e shkruar në përputhje me tezat e doktrinës së realizmit socialist. Romani paraqet versionin komunist të "heroizmit epik popullor", ku masat e udhëhequra nga mësimet e partisë, përmes heroit pozitiv, sekretarit Stavri Lara, kapërcejnë gjitë vështirësitë e mungesave teknologjike, por më fort punën sabotuese të inxhinierëve "të degjeneruar" e "armiq të popullit", që gjoja janë rekrutuar si spiunë nga ish mësuesi i tyre Harry Fultz. Se çfarë origjine etike e humane ka ky pushtet i ri, këtë në roman mund ta përkapim lehtë nga dialogu i protagonistit Stavri Lara, sekretarit të partisë. Stavri është përfaqësuesi i atyre që kanë ardhur në pushtet dhe do të themelojnë moralin e ri të drejtësisë, barazisë e vëllazërisë. Po sa çuditshëm tingëllon, kur pasi ka treguar mes familjarëve të tij tërë mikro-Odisenë e tij romantike të mbijetesës nga kampet naziste, zhvillon, që nga dushi ku po lahet, këtë bisedë me të ëmën:

"- Ku e keni gjetur këtë peshqir? Sa i madhe e i bukur qenka!

- Se mos kemi vetëm këtë. E kemi mbushur shtëpinë. Kemi marrë kolltukë, një raft me pasqyra, dy qilima, perde, takërme për të ngrënë bukë me dymbëdhjetë peceta. Janë të atyre borgjezëve <...> Ç'e do kur s'morëm edhe ca! Po s'dëshyt atë! "Të marrin edhe fukarenjtë e tjerë", thoshte! Po shtëpia si të duket? Nuk është si pallat? - S'e kam parë mirë, po pallat më duket!

- A e di se e kujt është? E atij që rri tani në kotecin tonë.

- Ashtuu? E atij burrit me gjyzykë?

- Hëëë! Ç'ka qenë ai! Të vëllanë ia pushkatuam. Një djalë e ka të arratisur në Itali. I kanë hedhur një milion franga tatim".

Vullnetarët dhe populli i thjeshtë ia dalin mbanë, falë vigjilencës dhe mësimëve të partisë. Triumfon sukcesi, Kënetë thahet. Makensen Bungo me romanin "Kënetë e vdekjes" jep një version të përmbysur të realeve të Fatmir Gjatës për të njëjtën Kënetë, për të njëjtin proces. Rrëfimi është shkruar nga perspektiva

e narratorit që dëshmon në mënyrë kronikale përditshmërinë e detajuar të një realiteti permanent vdekeprurës në kënetë, ku ndaj të burgosurve ushtrohen sistematikisht, ditë e natë, eksperimentet më çnjerëzore, të tilla që mund t'i ndeshesh vetëm në arsenalin e torturave nëpër kampet naziste të shfarosjes. Tipologjia zhanrore e këtij rrëfimi auto(biografik) në veprën letrare është, tashmë, gjerësisht i njohur në repertorin e krijimtarisë letrare, që e merr lëndën drejtpërdrejtë nga përvoja reale e kampeve dhe burgjeve, të tilla si romanet e Primo Levit ("A është vallë njeri ky?"), Imre Kertezhit ("Romani i një të pafati") Aleksandër Sollzhenicinit ("Arkipelagu Gulak", "Një ditë e Ivan Denisoviçit", "Pavioni i kancerrozëve" etj), rrëfimet e Varllam Shallamovit ("Tregimet e Kolimës"), Fatos Lubonjës ("Ridënimi"), Atë Zef Pllumit ("Rrno vetëm për me tregue"), Visar Zhitit ("Rrugët e ferrit", "Ferri i çarë") etj.

Përmes një realiteti ngjethës, që mpikset deri në makabritet, Bungo vizaton një tjetër të vërtetë në kronotopin e Kënetës dhe këtë e bën me realizmin e detajeve ngjethëse e shokuese. Autori, një i mbijetuar i Kënetës, na rrëfen fatin tragjik të një grushti studentësh nacionalistë të Normales së Elbasanit. Pasi lënë qelitë e burgut të qytetit të tyre dhe vetë profesorin e tyre të dashur, shkrimtarin Et'hem Haxhiademin, që po jep shpirt aty, ata dërgohen të vuajnë dënimin në Maliq. Parakalon në rrëfim figura e shkrimtarit Mitrush Kuteli në Kënetë, sikundërse dhe e profesorit-poet, Arshi Pipës, që dërgohet në spital. Romani mbyllet me kthimin e përgjysmuar të atij grushti miqsh idealistë. Dikush ka vdekur nga puna e sfillitëse, sëmundja dhe uria; dikush tjetër nuk e ka duruar sprovën e rëndë të mbijetesës dhe është bërë spiun, për një copë bukë, e më në fund, i turpëruar e i vetëneveritur var veten. Skenat e dhunës, torturës psikologjike, rrahjeve e poshtëtimeve, zhburrërimet e nëpërkëmbjet e nderit janë norma e përditshme në kamp. Heroizmi masiv i punëtorëve vullnetarë nga romanit propagandistik i F. Gjatës, ia lëshon vendin të vërtetave pataksëse e të shëmtuara: janë realisht të dënuarit politikë, rreth 2500 skllëvër, që janë dërguar aty për të mos dalë gjallë, çka përputhet saktë me faktet reale zyrtare në dokumente, raportime e dëshmi të tjera.

Botime të veçanta


## AGRON SHALA VJEN ME "SHEKULLIN XX"

("Shekulli XX: Pjesa I (1901-1950) vjen në botim të Shtëpisë botuese "Drini", Ferizaj)

Libri "Shekulli 20" është një sintezë bindëse e ngjarjeve të trazuar, lëvizjeve dinamike, ideve novatore, zbulimeve të thella dhe kthesave kryesore që përcaktuan shekullin e kaluar, por edhe ndikimin transformues që këta elementë patën në rrjedhën e historisë njerëzore. Duke përdorur me finesë metodën deduktive, autori Agron Shala nis një udhëtim gjithëpërfshirës, duke vëzhguar fillimisht peizazhin global përpara se të ngushtojë me përpikëri fokusin për t'u thelluar më pas në ngjarjet e rajonit të Ballkanit, e së fundi edhe tek ato kombëtare.

Duke adoptuar këtë qasje metodike, libri shpaloset si një ndërthurje komplekse e fijeve të ndërlikuara të historisë, duke i lejuar lexuesit të tërheqë paralele të thella midis rrymave gjithëpërfshirëse të historisë globale dhe kontekstit specifik të historisë shqiptare. Përmes efektit që sjellin krahasimet e tilla, tregimi u hap rrugë lexuesve për të identifikuar pengesat, për të dalluar arsyet themelore të shfaqjes së tyre, për të analizuar gabimet dhe pasojat që kanë sjell ato dhe për të vlerësuar hapat e bërë drejt përparimit.

Autori Agron Shala, në njëfarë mënyre edhe kësaj radhe vazhdon të zgjerojë horizontet e interesimeve të tij, të



njohura nga veprat e mëparshme, e në veçanti nga libri i fundit "1981-vidhe këtë libër", duke shfaqur kështu një vazhdimësi dhe një tablo më të gjerë të eksplorimit të peizazheve historike. Ky libër, ashtu si paraardhësit e tij, është një thesar informacionesh dhe faktesh, që mbështeten në një shumësi burimesh të ndryshme të referimit. Përmbajtja e tij e pasur përfshin një spektër të gjerë të veprimtarive njerëzore, që e bëjnë librin atraktiv dhe të dobishëm jo vetëm për lexuesit shqiptarë, por edhe më gjerë. Informacionet e shumta që hedhin dritë mbi aspekte të shumanshme të përpjekjeve njerëzore në mbarë globin, hulumtimi i përpiktë dhe mbulimi gjithëpërfshirës i rrjedhave të një shekulli, e bëjnë librin e Agron Shalës një udhëzues të domosdoshëm për këdo që kërkon një kuptim më të thellë të kompleksiteteve që kanë formësuar historinë tonë të përbashkët. Në thelb, ky libër e kapërcen rolin e tij si një tregim i thjeshtë historik; ajo bëhet një pasqyrë përmes së cilës lexuesit mund të reflektojnë mbi udhëtimin kolektiv të njerëzimit, duke nxjerrë urtësi si nga sprovat ashtu edhe nga triumfet e dokumentuara në faqet e tij.

(Z. SH.)

Ana tjetër e medaljes

## ORHAN PAMUK, VEPRAT, STILI DHE "MUZEU I PAFAJËSISË"

**Jeta ime, për shkak të shumë gjërave, ishte në krizë. Nuk dua të hyj në këto detaje, si: divorci, vdekja e babait, problemet profesionale, problemet me këtë, problemet me atë; gjithçka ishte e keqe**

**Përgatiti: Xhahid BUSHATI**

Orhan Pamuk, në maj të vitit 2007 ishte anëtar jurie në Festivalin e Filmit në Kanë. Ishte i ftuar nga regjisori britanik, Stephen Frears. Në verën e vitit 2008, përfundon romanin "Muzeu i pafajësisë". Pamuk krijoi një Muze aktual të pafajësisë, i përbërë nga objekte të përditshme të lidhura me narrativën. I vendosi në një shtëpi në Stamboll, shtëpi që e bleu. Pamuku bashkëpunoi, gjithashtu, në një dokumentar të titulluar "Pafajësia e kujtimeve", që më pas u bë "Muzeu i tij i pafajësisë". Pamuk tha se, "Muzeu i ëndrrave" do të tregojë një version tjetër të historisë së dashurisë të vendosur në Stamboll përmes objekteve dhe filmit të ri të mrekullueshëm të Grant Gee". Si në Snow ashtu edhe në "Muzeun e pafajësisë", Pamuk përshkruan histori tragjike dashurie, ku burrat bien në dashuri me gra të bukura me shikim të parë. Heronjtë e Pamuk-ut prirën të jenë burra të arsimuar, të cilët bien në dashuri tragjikisht me bukurshet, por që duken të dënuar me një vetmi të mjerë. Më 1 mars 1982, Pamuk u martua me historianen Aylin Türegün. Nga viti 1985 deri në vitin 1988, ndërsa ishte student i diplomuar në Universitetin e Kolumbisë, Pamuk mori pozicionin e studiuesit, duke përdorur kohën për të kryer kërkime në dobi të punës krijuese për nisjen shkrimore të romanit "Libri i zi", në Bibliotekën "Butler" të këtij Universiteti. Më pas, u kthye në



Stamboll, qytet me të cilin ishte shumë i lidhur. Në vitin 1991 ai dhe gruaja patën një vajzë, Rüya, emri i së cilës në turqisht do të thotë "ëndërr" dhe së cilës i kushtohet romani i tij «Emri im është i kuq». Në vitin 2002, ata u divorcuan. Që nga viti 2011 Pamuk ka qenë në një lidhje me Asli Akyavas, me të cilën u martuan në vitin 2022. Në vitin 2013, Pamuk ftoi Grazia Toderin, punën e së cilës ai e admironte, për të projektuar një vepër për "Muzeun e pafajësisë" në Stamboll. Bashkëpunimi i tyre kulmoi me ekspozitën "Fjalët dhe yjet". "Fjalët dhe yjet" u hap më 2 prill 2017, në Mart. Ekspozita flet "për prirjen

e njeriut për të eksploruar hapësirën dhe thirrjen e lindur për të vënë në dyshim yjet". Ekspozita u kurua nga Gianfranco Maraniello. U shfaq, gjithashtu, nga 4 nëntori 2016 deri më 29 mars 2017, si dhe nga 5-6 nëntor 2016 në Palazzo Madama, Piazza Castello, Torino dhe në Infiniti-to.

I pyetur sesa personal ishte libri i tij "Istanbul", Pamuk u përgjigj: "Mendova se do të shkruaja "Kujtimet dhe qyteti" për gjashtë muaj, por m'u desh një vit për ta përfunduar. Punoja 12 orë në ditë, vetëm duke lexuar dhe duke punuar. Jeta ime, për shkak të shumë gjërave, ishte në krizë. Nuk dua të hyj në

këto detaje, si: divorci, vdekja e babait, problemet profesionale, problemet me këtë, problemet me atë; gjithçka ishte e keqe. Mendova se nëse do të isha i dobët, do të kisha rënë në depresion. Por, çdo ditë zgjohesha dhe bëja një dush të ftohtë dhe ulesha, e kujtoja dhe shkruaja, duke i kushtuar gjithmonë vëmendje bukurisë së librit. Sinqerisht, mund ta kem lënduar nënën time, familjen time. Babai im kishte vdekur, por nëna ime, ende ishte gjallë. Por, unë nuk munda të kujdesesha për të shtrenjtën time. Më duhej të kujdesesha për bukurinë e librit".

Tregim

# NUDOJA E KRYQËZUAR NË TELAJO

Mirela Leka XHAVA

Prej vitesh punonim në atë institucion dhe gati çdo mëngjes e pinim bashkë kafënë. Unë në detyrën e gazetarit në redaksi dhe ai piktor grafist. Kuptohet që arti ishte strumbullari i bisedave tona të zakonshme. E ftova për kafe e m'u duk sikur s'ishte aq në qejf.

-Kafeja dhe dashuria pihen të nxehta!,- citova dikë që s'mbaja mend ku e pata lexuar.

-Vërtet ashtu, miku im!,- tha piktori, duke tundur kokën paksa të thinjur në tëmtha. Po i afrohej të dyzet e pesave megjithëse nuk dukej.

Sytë e tij ishin fiksuar në dritare e ndofta fantazia e tij ndiqte lojën e pikave të shiut mbi qelq. Ishte ditë e zyrtë dimri dhe të punoje në kompjuter atë ditë, do të ishte një lloj si të pije valium.

Mendova se ajo kafe do më rifreskonte e të vazhdoja ca punë të lëna përgjysmë.

- Aman, o Ladi!,- gati s'thirra si për ta shkundur nga ajo gjendje që më injektoi padashur.

-Se ç'ke sot, s'të shoh në rregull. Ndonjë frymëzim kështu a çfarë?

- Ah po, ke bërë fjalë me Zanën më duket. Mos të mban mëri për Tiranën, që s'u ktheve atë natë? S'ka faj, - i thashë dhe rrufita kafënë e mbetur në filxhan.

- Takova një shok të vjetër, - filloi të shfaqësohej ai.

- Mos m'i trego mua këto ti, djalosh - i thashë jo pa djallëzi.

-E mirë, një zonjë po të them,- e shove kureshtjen tani!,- ma ktheu si me inat dhe mendova se do të ngrihej të ikte.

- Takova "çudon",- filloi të fliste më shtruar. Menjëherë e kuptova për kë ishte fjala dhe e dija që kishte dobësi për të.

Kështu i pat mbetur emri asaj që kur ma pati treguar herën e parë historinë me të. Në fakt, i pëlqente ta hapte zemrën me mua dhe unë nuk e ngacmova më.

- Kaq vite pa u takuar,- vazhdoi qetë ai, - ishte martuar dhe kishte një djalë dhjetë vjeçar. Nuk të besohet, por u takuam sërish në autobus. Kishte mbetur po ajo, o zot, më e bukur, flokët biondë të gjatë mbi supe, sytë blu oqean, vetëm qe shëndosur ca.

-Eh mor Goni, vetëm mali me malin nuk takohen, - tha dhe trokiti lehtas mbi tavolinë me gishtat e zverdhur nga cigarja.

-Sigurisht!,- ia ktheva mendueshëm. E dija që kishin qenë në prag të fejesës, pas një viti të zjarrtë dashurie, por ajo ishte vajzë e vetme dhe prindërit e donin dhëndër brenda. Ai dhe njerëzit e tij nuk pranuan. Kështu u ndanë pa fjalë, si të ishte një ëndërr, një mirazh. Ndoshta dashuria e tyre nuk qe aq e konsoliduar, apo mbeti thjesht një ndjenjë e zgjatur kalimtare, apo vetëm dëshira pa dashuri...,- mendoja dhe hetoja sytë e tij, të cilët m'u dukën pak më të vegjël e të skuqur nën vetullat e trasha.

-U përmallua kur u takuam ashtu papritur dhe më ftoi në shtëpinë e saj atë natë. I shoqi ishte me audit në një qytet të largët jugor. Andej kishte njerëzit e tij dhe kishte marrë dhe të



birin me vete. Punonte si ekonomist në Insig. Në shtëpi ishte e ëma. Ajo e kuptoi nostalgjinë tonë dhe bëri atë që bëjnë vetëm nënat e moderuara. Iku. Ne mbetëm vetëm të dy. Zjarri dhe kasha pranë. Ajo vuri në tryezë ca prodhime të shijshme deti dhe ndezi qirinjtë e kuq në një shandan të madh. Po rijetoja ëndrrën pas kaq vitesh. Ndjehesha mirë atë ditë se pata mbyllur dhe marrëveshjen për pjesëmarrjen time në ekspozitën e Galerisë së Arteve në Tiranë. Ajo kishte etje...dhe unë gjithashtu. Vera beri efektin e saj. Nuk di sa vite të tjera mund të kalonim pa u takuar ose ndoshta kurrë. Nuk doja të kisha probleme tradhtie me gruan, por kjo rastësi paralidhej me fatin tim. Ishte e dashura dhe nudoja ime e parë pas studimeve. Shishja e verës së boshatisur u rrokullis mbi moket pa zhurmë. Ne rrinim të përqafuar mbi divan dhe buzët tona të nxehta shkisinin ngado mbi trupat tanë që avullonin, megjithëse jashtë bënte një i ftohtë qeni. Brenda ishte saharaja dhe unë ecja e ecja mbi të e nuk lodhesha kurrë. Ishte mesnatë kur hodha diçka mbi supe dhe iu luta asaj të pozonte nudo, siç ishte nën rrezet e zbehta të abazhurit. Vetëm hodha tej mbulesën e kaltër për të krijuar hapësirë rreth saj. Ajo rrinte shtrirë dhe nuk mërziçej me mua, ashtu si dikur. Kur po mbaroja skicimin, në sfond pashë varur te koka e shtratit një tablo nudoje. Ishte ajo që

kisha pikturuar dikur për të si dedikim. E putha me dhembshuri dhe ndjeva se u laga në sup. Ajo po qante.

- Nuk je e kënaqur,- e pyeta kureshtar për të ditur diçka mbi jetën e saj bashkëshortore.

- Jo, si do të isha me ty, - më tha dhe më ledhatoi lehtë mbi buzë me gishtat e saj të hollë si të një pianisteje.

- Megjithatë, mirëkuptohemi, fundja është babai i djalit tim që e dua shumë, i mirë në përgjithësi, i kulturuar, i respektuar, por një çikë racional dhe i ftohtë. Në çast m'u duk sikur i bëri karakteristikën e atij që kishte pranuar si burrin e saj në vendin tim.

-Më do në mënyrën e tij,- vazhdoi ajo. - E dua, jo se nuk e dua, por unë jam ndryshe...

Ajo fliste dhe mua më vinte keq për të, ajo ishte jeta dhe vdekja ime.

- Kam djalin - tha tha pas pak, - dhe me një lëvizje energjike të dorës fshiu lotët poshtë syve dhe hodhi flokët e dendur pas.

Po agonte mëngjesi dhe mendoja se nata e gjatë me "nudo" e dashur po mbaronte. Në qytetin tim më priste gruaja me vajzën dhe diçka e mprehtë m'u duk se më ndau përgjysmë trupin. Nuk e lashë të më përcillte, por dukej se dhe ajo nuk donte të ekspozohej. Priste me gëzim djalin të kthehej dhe në sytë e saj pashë gëzim e pafajësi. Djali ishte bota e saj dhe atë ia kishte dhuruar vetëm ai.

-Hej dreq, kurrë më! - thashë me vete dhe papritur më kaploi një mall për gruan time që më priste e merakosur në shtëpinë tonë të ngrohtë. Kishim mbetur vetëm, se fëmijët kishin ikur për studime jashtë vendit.

...Piktori ia filxhanin e kafesë dhe befaz u ngrit. Pasi bëri dy - tre hapa, më thirri ta ndjek pas në studion e tij. Drejtoi nga unë kavaletën dhe para meje u shfaq ajo "çudoja" e tij. Aq engjëllorë dukej mbi shtrat sa çdo burrë do të thyhej para saj si përpara Helenës së Trojës.

-Paske qenë me fat, - i thashë, - pa i hequr sytë prej saj, që të tërhiqte si me magji.

Befaz mendova se sa herë do ta riprodhojë atë deri në fund të jetës së tij. Sikur të ma kish kuptuar mendimin tha: Kurrë më!,- dhe me penelin të ngjyer me bojë të kuqe bëri një kryq të madh mbi të. Më erdhi keq dhe desha ta ndaloja, por ajo që u bë, nuk zhbëhej më. Nudoja u kryqëzua sakaq.

Më mirë kështu, as ritakime, as riprodhime nudoje, secili në jetën e vet, - shtoi ai dhe çuditërisht m'u duk më i qetësuar si mbas një uragani.

Sigurisht, ai do ta hidhte më pas në kosh nudo, që s'u bë për fat gruaja e tij, por ngeli numri një në serinë e gjatë të nudove që kishte pikturuar gjatë jetës së tij profesionale si artist.

-Ndoshta, më mirë kështu! - tha dhe ndezi sërish cigaren që nuk kishte guxim ta linte asnjëherë...

## Poezi: Hamit ALIJAJ

### ASKUSH S'E DIN DRAMËN E DRURËVE

Askush s'e din dramën e drurëve të pagojë.  
Ata janë kalendarë:  
çdo vit që ka shkuar,  
është një rreth në trupin e tyre.  
Drurët kanë ankth:  
s'e dijnë çfarë u bën njeriu, ndaj grinden me rete.  
Njëri jeton ankthin se do bëhet kryq,  
o për kryqëzime të reja, o kryq te kryet e një vorri.  
Tjetri pret të bëhet derë,  
(jetime endacake, drita pret pasdere),  
krevat ku shfryhen epsheet e botës.  
Trishtohen drurët që do të bëhen karrike,  
ku ulen tirdnët, që pjellin krime.  
Drurët jetojnë dilemen e madhe të kohës: kur do bëhen zjarr,  
flaka e tyre njeriun do të ngrohë, a do djegë qytetërimet?  
Lumturohen ngapak drurët që do të bëhen letër,  
ku do të shkruhen lirika dashurie,  
por prap i zë ankthi i germës së shpikur nga njeriu,  
dyshimi i madh se në cilën letër të dalë nga drurët,  
do firmosen shpallje lufte a urdhëra pushkatimi?!  
Drurët trishtohen nëpër qytete,  
kur i mbjellin në rresht e ngjajnë si ushtarë.  
Drurët vetëm për një gjë i tremben vdekjes:  
se vdekja e tyre është mërgatë e pakthim e zogjve.  
Drurët flejnë jashtë, në natën e botës.

### DIMËRIM LAHUTASH

Krahë për krahë,  
shëtitores së qytetit të përhënur,  
ecin të vdekurit, që u kushtohen këngë  
e të gjallët, që duan të bëhen këngë.  
Mërijaz qayren ndërveti,  
të vdekurit, që u këndohen këngë  
e të gjallët, që duan të hyjnë në këngë.  
Merreni këngën tonë e na jepni ditën tuaj, thonë të vdekurit.  
Ne duam edhe këngën, edhe ditën, thonë të gjallët!  
Po kënga don koka, o të mjerë,  
thonë të vdekurit me këngë!  
Dhe kokat e të gjallëve bëhen lahuta,  
kokat e të gjallëve, që duan të hyjnë në këngë.  
Qytet sonambul, me njerëz kryelahuta!  
Këngëtarët e vdekur,  
kthehen me luftëra në shpindë.

### KËMBANË E LARGËT

Tash prekjet e mia  
s'e bëjnë më kitarë trupin tënd,  
veç rënkim të një këmbane të largët,  
të një kishe të harruar në mal.  
Dherat dhe qiejt hyjnë në natë  
e hesht zogëzimi.  
Piprron veç lorza shtjerrakeqe,  
hu-hu-hu, hukatë huti mbi pyje,  
dervish i fateve të natës.  
Prej rënkimit të dheut del një dritë përshpirtje,  
në trajtën e një gruaje.  
Perënditë antike dalin nga rrënojat  
e zbathur rendin pas saj.  
Perëndi antike, murgjër të lashtë,  
bjeruni këmbanave në tempujt tuaj,  
kitarave veç unë di t'u bie.

### QIEJT UDHËTARË

Këta qiej vjeshtorë me zogj që ikin  
Krejt syve tu m'u ngjajnë përherë,  
Një vetëtimë zhvirgjëron qiellin  
Dënes në ty ,si atëherë

Dhe janë dy gjëra që s'u shpëtoi  
Askush i gjallë mbi këtë dhe :  
Njëra është plakja,e tjetra vdekja  
Ti , pa të dyja mua më le !

Si Dhevështruesi diku mbi glob  
Syri i NASA-s përgjon gjithësinë,  
Zbulon planete të padëgjuar,  
Po asgjë të re për dashurinë !

Dhe në delir janë qiejt e epërm  
Ku shi s'bie kurrë e s'ngjiten retë,  
Veç ti e din atë formulë,  
S'më le me u plakë, s'më le me vdekë ...  
Tropojë, 27 gusht 2019

### S'PO BËHET DITË...

E pata lidhë natën për lisi  
Si një kalë të zi,  
-Ti s'do të ikësh, derisa të dal unë, i thashë,  
E hyna në kullën që kish për dritare  
Sytë e një vajze

Nata më priti aq gjatë  
Sa i thinji zogjtë  
Në gjinjtë e vajzave

Atë ditë e sot  
Hingëllin lisi  
Sa herë kalojnë nuse andej

Dhe del prej tij nata,  
E kthyer në një kalë të bardhë...

Në Alpe, 1 shtator 2019





Një bisedë me Threa Almontaser

# TEKSTI I EGËR DHE I TËRBUAR

**Mendoj se ajo që ndikoi në pjesën tjetër të fëmijërisë sime ishte, pas 11 shtatorit, mënyra sesi u trajtuan arabët në tërësi. Frika u bë një fiksim i përhershëm. Prindërit myslimanë kishin frikë për fëmijët e tyre dhe prindërit e mi nuk bënë përjashtim**



**Nga Renee H. SHEA**

“Dhelpra e egër e Jemenit” nga Threa Almontaser (jemeno – amerikane), mori çmimin ‘Walt Whitman’ të Akademisë së Poetëve Amerikanë për librin e parë më të mirë në vitin 2020, gati një vit përpara se të botohej nga Graywolf Press. Në deklaratën e jurisë, poetja Harryette Mullen e vlerësoi autoren për “larminë formale dhe gjuhësore... e guximshme, sfiduese... deklaratat... [që] pyesin sesi t’u përkasim të tjerëve pa humbur veten, si të jesh besnik ndaj vetes pa i braktisur të tjerët.” Almontaser, e cila është amerikane jemenase, u rrit në qytetin e Nju Jorkut dhe afër kohës kur ajo po fillonte kolegjin, familja e saj u vendos në Karolinën e Veriut. Diplomoi në anglisht dhe mori diplomën MFA nga Universiteti Shtetëror i Karolinës së Veriut. Me një certifikim TESOL, ajo vazhdon t’u mësojë anglisht emigrantëve dhe refugjatëve në zonën Raleigh-Durham.

Ajo ka marrë çmime nga Fondacioni Civitella Ranieri në Itali dhe Fondacioni Kombëtar për Artet. Pasi Bursa Fulbright që ajo mori në 2021 u anulua për shkak të Covid-19, ajo riaplikoi dhe mori një tjetër për të kryer kërkime në Malajzi për vitin 2024-2025. Almontaser shërben si redaktore për Tinderbox Poetry Journal dhe në një juri për Çmimet Scholastic Arts and Writing. Ajo aktualisht është duke punuar në një roman, atë që ajo e përshkruan si “një histori që njollos një vijë midis fantazisë dhe ditës aktuale, magjepsjes si fqinje me jetën reale”. Një projekt afatgjatë është një përmbledhje e dytë poetike që, pikërisht tani, thotë ajo, “është kthim të mendjes sime, por më duhen shtatë vjet për të përsosur një poezi”.

Almontaser fitoi çmimin përurues të librit Maya Angelou në 2021 për demonstrimin e një përkushtimi ndaj

drejtësisë sociale përmes poezisë së saj. Si ky çmim, ashtu edhe çmimi Walt Whitman tërheqin vëmendjen për mënyrën sesi vepra e saj pasuron traditën e letërsisë amerikane. Megjithatë, ajo ka një shtrirje globale në shumë poezi të tilla si “Ju lutemi hiqni këpucët tuaja para se të hyni”, e cila i kushtohet “muslimanëve të masakruar në Christchurch, Zelandë e Re”. Ashtu si poezitë në ‘The Wild Fox of Jemen’ (Dhelpra e egër e Jemenit), fjalët hyrëse në faqen e saj të internetit janë një ftesë për t’u vlerësuar, si dhe një haraç për “përkatesinë e dyfishtë” të saj: Ju lutemi hiqni këpucët para se të hyni!

**SHEA:** Në vitin 2023 ju ishit poetja e zgjedhur për Rrethin Shkencor dhe Letrar Chautauqua, duke iu bashkuar radhëve të Tyehimba Jess, Jane Hirshfield dhe Ilya Kaminsky. Si ka qenë përvoja juaj në atë përvojë të vullshme letrare dhe intelektuale?

**ALMONTASER:** Ishte një eksperiencë e pabesueshme. Ndihesha si një cikalë\* që po ngjitej nga vetja. Njerëzit që jetonin aty pranë më pranuan me shpejtësi (madje një i huaj më dha hua biçikletën e tij) dhe një vullnetar i ri erdhi tek unë pas leximit tim për të më falënderuar, sepse ai kurrë nuk kishte dëgjuar muzikë rap të bënte jehonë nëpër atë lagje dhe kjo i dha atij gëzim të madh që kam luajtur një këngë dhe e kam analizuar gjatë leksionit tim në amfiteatër.

**SHEA:** Ju e keni quajtur Dhelprën e Egër të Jemenit “një letër dashurie për Jemenin”. Tani që ka dalë në dritë - dhe duke pasur parasysh situatën në ndryshim në Lindjen e Mesme - a e kap akoma ai përshkrim qëllimin tuaj?

**ALMONTASER:** Po, mendoj tani më shumë se kurrë. Ndërsa vende të tëra fshihen nga imperializmi, poezia,

esetë dhe gazetaria dhe dëshmimi dhe mësimi i historisë së vërtetë të atyre kulturave ndihmon për të shkruar përsëri drejt asaj që fshihet në kohë reale.

**SHEA:** Një nga temat e vazhdueshme të punës suaj është ndikimi i ndjenjave anti-muslimane mbi ju si një vajzë e re, familjen tuaj dhe komunitetin më të gjerë. Në “Gjuetia e vajzërisë”, ju shkruani: “[Nëna ime] thotë, Mos utrego e pamatur. Unë them, e vërteta është, / hoqa dorë nga të qenit i kujdesshëm në klasën e tretë / kur ranë kullat dhe më vonë, veshja / urrejtitjen e qytetit si hixhab. Në çfarë mënyrash, përveç të dukshmes, ishte 11 shtatori momenti përcaktues, një pikë përkuljeje për ju?

**ALMONTASER:** Mendoj se ajo që ndikoi në pjesën tjetër të fëmijërisë sime ishte, pas 11 shtatorit, mënyra sesi u trajtuan arabët në tërësi. Frika u bë një fiksim i përhershëm. Prindërit myslimanë kishin frikë për fëmijët e tyre dhe prindërit e mi nuk bënë përjashtim. Qofshim në shtëpi apo jashtë, ishte si t’i dorëzoheshim botës. U desh një trimëri e madhe për të mbetur “i pamatur” dhe për të luftuar kundër.

**SHEA:** Një nga poezitë më të fuqishme për mua është “Siguria e shtëpisë pas 11 shtatorit” (fragment): Miratimi (Pëlqimi): nëse policia shfaqet në derën tuaj dhe ju pyet nëse mund të hyjë brenda për të kontrolluar dhe ju pranoni kontrollin, atëherë policia nuk ka nevojë për një urdhër.

*Në pushim të hënës,  
Një derë e përparme u Herkulos  
Tek pluhuri i pishës, fëmijët që ëndërrojnë  
[.]  
Të detyruar nga gjumi,*

*Qentë na kullosin në një shpellë me natë  
Aty ku një nënë po qan,  
Më lejoni të kap një shall, vetëm një shall.*

*Me mendje të zymtë në shkëlqimin e tij meteor,  
Tinguj statikë që tingëllojnë gjithë bllokun,  
Unë besoj se jemi duke u rrëmbyer nga [.]*

Një nga recensentët tuaj pohoi se çdo antologji e 11 shtatorit, do të ishte e paplotë pa përfshirjen e kësaj poezie - duke sugjeruar që të dëshmosh siç bëni ju këtu është një element thelbësor i kujtimit. Në çfarë mënyrash mendoni se mund të përjetohet kjo poezi nga një brez që nuk ka lindur ende gjatë 11 shtatorit?

**ALMONTASER:** Është bërë edhe më i përhapur - nuk ka qenë kurrë vetëm një problem mysliman. Kalimi në fazën e tretë të përgjigjes kërkon që amerikanët të bëjnë pyetje që testojnë vlerat tona si individë. Ekziston një instinkt natyror për të kontribuar me atë që mundemi dhe pastaj të vazhdojmë. Pas 11 shtatorit, ndjeshmëria njerëzore i la shpejt vendin pyetjes përçarëse: Çfarë duhet të bëjmë për t’i bërë “ne” të sigurt nga “ata”? Ishte e pakëndshme për shumë njerëz të vinin në dyshim rolin e Amerikës në sulmet terroriste, ose të rishqyrtonin fuqinë tonë dhe mënyrën sesi e përdorim atë. Në vend të kësaj, politikanët i përvetësojnë këto momente të mëdha mundësie dhe na çojnë prapa. Ky gjenocid i fundit është jo më pak një mundësi për ta ngritur reagimin tonë individual të kujdesit në nivel kombëtar.

**SHEA:** Ju shkruani me një gamë kaq të jashtëzakonshme referencash nga kultura letrare, mitologjike dhe popullore: Moisiu dhe Medea bëjnë shoqëri me Fugees dhe Nikki Minaj, Mahmud Dërvishi me Natalie Diaz dhe Robert Hajden, për të përmendur disa. A jetojnë të gjitha këto burime në kokën tuaj në të njëjtën kohë - si frymëzim?

**ALMONTASER:** Më pëlqen të ndjek kuriozitetet dhe impulset e mia të çuditshme - duke festuar këto dallime të ndryshme - të qëndroj kurioz dhe të mos lejoj që përmbajtja të diktojë strukturën. Gjithçka është bërë nga një kolazh i gjërave të tjera. Më pëlqejnë poezitë që referojnë tetë, nëntë ose dhjetë gjëra, ndërsa demonstrojnë sesi të gjitha ato mund të lidhen. Pyes veten, çfarë më pëlqen saktësisht nga kjo formë e medias? Çfarë po bëjnë mirë? Cili atom i kësaj zeje po ngjall veçanërisht interesin tim, duke më bërë të dëshiroj të punoj në artin tim? Mënyra e vetme për t'u siguruar që aftësia juaj përputhet me shijen tuaj është të vazhdoni të ushqeni kuriozitetin tuaj, të jeni në ndjekje të vazhdueshme të saj.


**SHEA:** Poeti jemenas, Abdullah El-Baraduni (1929-1999), është një ndikim thelbësor mbi ju si poete dhe si person. Ju keni thënë se jeni habitur kur zbuluat se "Nga mërgimi në mërgim" është e vetmja nga poezitë e tij që është përkthyer në anglisht dhe keni filluar ta rregulloni këtë duke përkthyer dy nga poezitë e tij që janë përfshirë në Wild Fox ("Kur njerëzit mallkohen", "Pse hesht për vajtimin"). A mendoni se ai do të ishte i kënaqur jo vetëm me përkthimin tuaj, por edhe me përpjekjet tuaja për ta prezantuar atë me një audiencë anglishtfolëse?

**ALMONTASER:** Unë do të doja të besoja se të gjithë poetët politikë, përfshirë Baradunin, përipiqen që zërat e tyre të dëgjohen për shumë vite dhe shumë veshë, qofshin ata duke bërë turr për revolucion apo shqetësimet për fqinjët apo për veten e tyre. Mary Oliver i pëlqen të thotë se ajo shkruan poezi për një të huaj që do të lindë në një vend të largët qindra vjet më vonë prej tani - por edhe për përkthimin e mendimeve të dikujt që kishte jetuar, luftuar dhe dashuruar përpara kohës tuaj.

**SHEA:** Në "Për procesin e të shkruarit", ju theksoni se "shkrimtarët me ngjyrë gjithashtu lejohen të shkruajnë për universalen, jo vetëm për specifikat" - një pohim që paralajmëron atë që Chimamanda Ngozi Adichie e quan në mënyrë të famshme "Rreziku i tregimit të vetëm". Si i keni thurur histori të familjes suaj, festime të kulturës suaj, të vendit tuaj (të quajtur në vitin 2022 si "vendi më i varfër në tokë") që qortojnë stereotipet dhe tregtojnë histori të vetme vuajtjesh me përshkrime të një kulture jetike dhe të pasur? Mendoj për "tezet-hallat" e lavdishme në poezinë tuaj, si për shembull artistët e kënasë që "me durimin e tyre, [po] i kthejnë gjymtyrët e zbehta / në një mural misterioz" ("Lëkurë e njollosur").

**ALMONTASER:** Është përgjegjësia jonë të shkruajmë për komunitetin jemenas për më shumë se vetëm mbijetesën tonë, por edhe gëzimet tona. Sa herë që lexoj një poezi vërtet të mirë, mendoj se kjo është më e vjetër se unë dhe kjo do të më zgjasë. Ne shkruajmë për gëzimin, jo vetëm sikur, por sepse ai tashmë ekziston. Dhe nuk duhet të ketë fshirje të vetvetes autentike dhe origjinale.

**SHEA:** Ju gjithashtu keshilloni në "Për procesin e të shkruarit": "Lini vend për hibridizimin e gjuhës. Kuptoni dështimet e përkthimit. Krijoni hapësirë për shumë anglezë." Ju krijoni fjalë të reja, ndoshta neologjizma, por duket se kënaqeni duke i dhënë një fjalë ose shprehje angleze jetë të re, shpesh duke ndryshuar pjesën tradicionale të të folurit. Pra, ne kemi "një derë të përparme të Herkulizuar", "kur arabizoj rrugën time drejt tyre", "duke riformuluar hundën time Pinokios" dhe "Unë / e tëhuaj rrugën time për në



vendin e tij". "Bodygarden" dhe "bijë", fjalë të reja, bëjnë rrugën e tyre në poezi të tjera - dhe kanë kuptim të përsosur! Si e bëni këtë?

**ALMONTASER:** Thjesht ndodh! Është pjesa më e mirë e të shkruarit për mua, më e këndshme. Mund të eksploroj ekosistemet e termave në kokën time, të gjitha mënyrat sesi mund të "shkruaj për të zbuluar", pa kufizime (të vetë-imponuara ose ndryshe). Unë ulem pranë kompjuterit tim dhe mendoj: Sa mund t'i afrohem ndjenjës që po përipiqem të përcjell? Më pëlqen të rilexoj një poezi më të vjetër dhe të habitem me zgjedhjen time të fjalës, si një zbulim i rijetuar. Më pëlqen alkimia e atij veprimi - të shpikjes së sendit, pastaj të befasoj veten me të pa pushim.

**SHEA:** Nuk do të supozoja t'ju pyesja se kush është "dhelpër e egër" ose çfarë përfaqëson ai/ajo, por le të themi se duket se ka shumë dhelpër në këtë koleksion. Për të cituar disa: në "Heritage Emissary" (Emisari i trashëgimisë), babai juaj tregon një histori për fëmijërinë e tij, "duke kapur një dhelpër të egër me kushëririn e tij - arabisht / mediuin përmes të cilit trupi i tij mund të kthehet në shtëpi"; në "My Father Finds Home through the Birds" (Babai im gjen shtëpinë përmes zogjve), "Ka një grabitqar që mbledh leshin e dhelpërës në sqepin e tij." Një recensues përshkruan "dhelpërën" e leximit të poezisë suaj, duke spekuluar se "një dhelpër e sakrificës mund të jetë një imazh i vetë Jemenit" ose ndoshta ju - autorja - jeni dhelpër. Çfarë duhet të bëjmë me këtë dhelpër të egër që është e pranishme kudo?

**ALMONTASER:** Më ka tërhequr ideja se mashtruesi i shqetësos gjërat nga një lloj urie dhe se, në disa raste, nuk mund të dallosh se në anën e kujt është mashtruesi (ose kush janë ata). Është e rëndësishme që poetët të marrin në pyetje në mënyrë të vazhdueshme. Përdorimi i dhelpërës si preokupimi qendror i librit më ndihmoi ta kuptoj plotësisht shkrimin si një mënyrë kërkimi. Kjo pyetje - veçanërisht e

institucioneve dhe marrëdhënieve në to - më kujton një mashtrues që mashtron një armik ose një mik. Doja ta bëja lexuesin të dyshonte për mua. Për të hetuar motivet e mia. Besoja se kjo do ta bënte lexuesin më aktiv, për të shqyrtuar me të vërtetë fjalët që po shkruaja.

**SHEA:** Dëshironi t'i bëni lexuesit "dysues" ndaj jush në mënyrë që t'i bëni ata "më aktivë"? Tani, kjo është intriguese. Ju keni thënë se ndonjëherë shkruani në arabisht jo vetëm sepse është pjesë e identitetit tuaj, por edhe "për ta bërë lexuesin të ndihet po aq i hutuar, i shqetësuar, i ndarë dhe i pavend si folësi që kërkon strehim". Vetëm në një poezi, hasa në fjalë si: ma'tuf, divan, fahir, galabijat, thobes, rahman, futah, misvak - mjaft të frikshme! Nga njëra anë, përfshirja e një gjuhe të tillë mund të nxisë ndërgjegjësimin ose vlerësimin kulturor, por a nuk shqetësoheni se fjalët dhe aludimet arabe mund t'i largojnë lexuesit?

**ALMONTASER:** Nuk më kishte shkuar kurrë në mendje që dikush do të mund të largohet. Unë supozova se do të ishte e këndshme të gjeja përkufizimet, si një gjueti thesari, duke përdorur Google ose të dhëna të kontekstit ose një mik që flet arabisht për të gjetur përgjigjet.

**SHEA:** Në disa poezi, nuk janë vetëm gjuhët që ndryshojnë, por edhe forma; për shembull, në "Gjuha e njohur", ju kaloni në strofën e tretë nga forma tradicionale perëndimore nga e majta në të djathtë tek e djathta në të majtë. A është kjo një sfidë, një kujtesë se ka një mënyrë tjetër, një enigmë - apo çfarë? Gjithashtu, a është përdorimi juaj i [ ] - kllapa me hapësirë të hapur - një mënyrë për të angazhuar lexuesin?

**ALMONTASER:** Në arabisht, ne shkruajmë nga e djathta në të majtë, gjë që imitonte ajo formë. Dhe kam përdorur kllapa për poezi si "Siguria në shtëpi", sepse pushtimet janë një formë heshtjeje, ose si fëmijë, ndonjëherë ke shumë frikë të thuash atë që kishte

ndodhur me zë të lartë, përndryshe ajo ngurtësohet në realitetin tënd.

**SHEA:** Është mahnitëse të shohësh sesa shumë ndodh në këto poezi! Me gjithçka që sapo keni përshkruar - dhe besimin tuaj tek lexuesit tuaj që jo vetëm takohen, por shijojnë çfarëdo sfide që mund të hasin - si e keni bashkuar të gjithë koleksionin? Më interesojnë tre "pjesët" dhe mënyra sesi dolën, por edhe forma e poezive në faqe - gërvishtjet, hapësirat, ngulitja. Ju përfytyroj në kompjuterin tuaj duke lëvizur fjalë dhe fraza përreth ndërsa "dizajnoni" poezitë: a është hapi i fundit pasi të keni vendosur gjuhën(t)?

**ALMONTASER:** Padyshim që më dukej sikur po projektoja brendësinë e një shtëpie - shumë punë në nivel arkitektonik. Tre seksionet thjesht kishin kuptim për mua në atë kohë për sa i përket mënyrës sesi funksionon rritja njerëzore: një fillim, një ndërmjet dhe një pas. Në përgjithësi, doja që gjuha ime poetike të ndihej si një rezistencë ndaj pritjeve. Shkrimi si një dinamikë riparuese, krijimi i një peizazhi të ri në faqe dhe shërimi nga ekspozimi i stereotipeve koloniale. Doja që çdo linjë të ofronte një imazh të ri për veten tonë. Ajo mendësi e shumëllojshme më ndihmoi të mbetem krijuese me formën.

(...)

**SHEA:** Në poezinë "Uria mbështillet", ju i referoheni "Shpresa-sëmundja e pashërueshme / sëmundja e Dërvishit" - një kombinim i pazakontë. A gjen shkak për shpresë sot, apo vetë mundësia është një mashtrim, një dobësi - një sëmundje?

**ALMONTASER:** Mbajtja e shpresës për shumë njerëz është si të ecësh në një rrjetë merimangash. Mund ta ndjeni në fytyrën tuaj, por nuk mund ta shihni. Megjithatë, mendoj se ia vlen të mbash sytë hapur. Poetët, për mua, janë mishërimi i shpresës. Të dyja shkojnë dorë për dorë. Ata prekin lëvizjet e rezistencës dhe demonstratat publike gjatë gjithë kohës, si daulle në vend të daulles. Kur përdoret në mënyrën e duhur, mund të nxisë njerëzit që udhëheqin një përpjekje kolektive ose të sjellë më shumë këmbë në marshim, duke i nxitur ata të shkelin më fort. Poetia fuqizon shpresën. Dhe shpresa e fuqizon lëvizjen.

**SHEA:** Në "Ode to Bodega Cats" (Ode për macet Bodega), ju shkruani: "Gjithçka që dua është të jem një paraardhës adekuat / për gratë jemenase që vijnë pas". A jeni e kënaqur që kjo përmbledhje debutuese e poezisë suaj ecën drejt këtij qëllimi?

**ALMONTASER:** Po, jam shumë krenare se ku ka arritur ky koleksion. Unë dua që çdo vajzë jemenase që e lexon të ndihet e nderuar, e njohur dhe ta vërejnë këtë. Shpresoj që pasi ta lexojnë, të vendosin të shkruajnë edhe ato. (Marrë nga [www.Worldliteraturetoday.org](http://www.Worldliteraturetoday.org))

**Përshtati në shqip: Fitim Nuhiu**

\* "Cikada" është fjala suedeze e cila i referohet insektit të njohur për zhurmën e tij të veçantë, të zhuurrshme të prodhuar nga meshkujt. Cikadat janë pjesë e rendit Hemiptera dhe kanë sy të spikatur, krahë transparentë dhe mund të jetojnë për shumë vite, duke kaluar pjesën më të madhe të jetës së tyre nën tokë përpara se të dalin për t'u çiftuar.

Profile: Xhon Keruak

# NJERIU "JERM" I SHTËPISË PREJ XHAMI

**Kishte një kujtesë të jashtëzakonshme. Kjo i dhuroi qysh herët nofkën "Memory Babe". E ndihmoi shumë edhe në shkrimin e romaneve të tij, më të shumtat e të cilave mbështeten tek kujtimet e mëparshme të jetës. I pëlqente shumë leximi, prandaj qysh herët tregoi mundësitë letrare. Formulonte periodikët e tij, të cilat madje i ilustronte edhe me ikona**

## Grigor JOVANI

Nëqoftëse pranojmë që me brezin "Bit" në Amerikën e fundviteve 40-të të shekullit të kaluar nënkuptojmë një mënyrë të veçantë jetese dhe një trashëgimi kulturore po të tillë, atëherë automatikisht kemi sjellë në mend themeluesin e saj, Xhon Keruak (12 mars, 1922 - 21 tetor, 1969), i cili, në fund të fundit, shpiku edhe termin përkatës. Ky term nënkupton gjithashtu edhe telendisje, shfarosje (beaten up), por edhe një gjendje jermi, gjer në ekstazë. Dhe e shpjegoi vetë, më tej: "Kjo do të thotë "Bit": "Jetoje jetën tënde? Jo, dashuroje jetën tënde! Kur do të vinë të të stisin në mur, për të të gjuajtur me gurë, të paktën do të kesh shtëpi prej qelqi, do të kesh vetëm trupin tënd prej xhami..."

Ishte romancier i njohur amerikan, që me filozofinë e tij "Bit", ndikoi brezat e mëvonshme, gjer edhe kolegë të shquar të shkrimit. Thuhet se ai është shkaku që Alen Ginzberg zgjodhi titullin "Britma" për veprën e tij, si edhe Uiliam Baruzh për "Vakt i zhveshur".

Gjithë jetën mbeti dygjuhësh, gjashtëvjeçar akoma zotëronte dy gjuhë, anglishten dhe frëngjishten. Në një kohë që në shtëpi përdornin gjuhën "joul", një dialekt kebekian i frëngjishtes, i cili përçmohej nga anglofolësit amerikanë dhe shërbente si shkak mënjanimi dhe diskriminimi.

Përfjetoi rritjen në një shoqëri frëngokanadeze punëtorësh të Louel-it. Miqtë e tij më të ngushtë ishin greko-amerikanë. Më 1926 humbi vëllanë e tij, Zherar, prej një epidemie ethesh, ngjarje tragjike të cilën e përjetoi thellë, dhimbshëm dhe e shtyu të shkruante më vonë romanin "Vizionet e Zherarit".

Kishte një kujtesë të jashtëzakonshme. Kjo i dhuroi qysh herët nofkën "Memory Babe". Endihmoi shumë edhe në shkrimin e romaneve të tij, më të shumtat e të cilave

mbështeten tek kujtimet e mëparshme të jetës. I pëlqente shumë leximi, prandaj qysh herët tregoi mundësitë letrare. Formulonte periodikët e tij, të cilat madje i ilustronte edhe me ikona.

Duke u rritur, Xhoni i shkathët dhe atletik u bë lojtar shumë i mirë në bejzball (futbolli tradicional amerikan), aq sa fitoi një bursë falas për në Universitetin "Kolumbia" të Nju Jorkut. Si student i "Kolumbias", erdhi në kontakt me disa prej personaliteteve të mëvonshme të brezit të "Bit"-ve, siç qenë Alen Ginsberg, Edie Parker, Lucien Carr dhe Uiliam Baruzh. Me ta bashkë ravijëzoi tiparet botëkuptimore të një brezi të tërë në Amerikën e fundviteve 40-të. Atë periudhë, në një bashkëbisedim me shkrimtarin John Clellon Holmes, Keruak përshkruajti miqtë e tij dhe në përgjithësi gjithë brezin e tyre si "të lodhur shpirtërisht me jetën dhe botën, duke pasur një ndjenjë të humbjes (beatness)", formulontas kështu për herë të parë termin "Beat Generation".

U martua me miken e "Kolumbias", Eddie Parker (1944), por u ndanë pas disa muajsh, ngaqë gjërat nuk mund të ekzistonin natyrshëm për një kohë të gjatë në jetën e tij.

Aventura e "Kolumbias" nuk zgjati shumë, si çdo gjë e rëndësishme në jetën e vetë të shkapërderdhur. Theu këmbën gjatë vitit të parë në një ndeshje bejzbolli. Nga ana tjetër, marrëdhëniet e këqija me trajnerin e tij, e shtyu të braktiste studimet dhe të kthehej në vendlindje, ku filloi të punojë si reporter sportiv i gazetës "Lowell Sun".

Në fillimet e viteve 40-të (1942) u punësua në flotën tregtare, për të filluar udhëtimet e gjata nëpër botë me anije të ndryshme. Vitin tjetër, në kohë lufte, u regjistrua vullnetarisht në Flotën Luftarake, por u përjashtua pak muaj më vonë, për shkak se ishte i padisiplinuar dhe me gjendje psikike të dyshimtë. Më

vonë iu lejua të rikthehej dhe shërbeu në inteneraret SHBA - Angli, me anijen luftarake "S.S. George Weens".

Romani i tij i parë "Oyteza dhe qyteti" (The Town and the City) u botua më 1950. Kishte filluar ndërkohë të udhëtonte vazhdimisht nëpër gjithë Amerikën dhe në Meksikë, bashkë me mikun e vetë Nil Kassadi, herë duke e pasur si bashkudhëtar në makinë, herë me "autostop". Kjo aventurë e gjatë udhëtimesh shërbeu si bazë për romanin e tij më të mirë "Në rrugë" (On the Road). Më 1950 u martua me gruan e tij të dytë, Joan Haverty. Me Xhoanën kaloi vitet më prodhimtare në krijimtari. Shkruante me pasion. Kështu erdhën romanet bazuar tek udhëtimet e veta: "Vizionet e Kondit", "Doktor Saks", "Magi Kasidi" e të tjera.

Gjatë viteve 50-të filloi të studiojë budizmin. Shkak i kësaj manie të re u bë vepra e Dwight Goddard "Bibla Budiste". Gjatë një udhëtimi në Meksikë përfundoi serinë poetike "Bluz në Meksiko Siti" (Mexico City Blues). I kësaj kohe është edhe romani "Tristesia" (Tristessa), i shkruar për një vajzë që njohu në Meksikë.

Disa nga romanet e tij të tjera, janë: "Rrugacët e Darmasë", "Hipoltonët", "Kotësia e Duluoazit", "Shkrime të përjetësisë". Ka botuar edhe gjashtë vëllime me poezi.

E tërhiqte publiciteti. Filloi të shkruante tek periodikët e njohur "Playboy", "Swank", "Holiday", "Escapade" dhe "Esquire".

Martesa e dytë, ajo me Xhoanën, zgjati më shumë se të tjerat, por gjithashtu si të tjerat, nuk qe e gjithëherëshmjia. Më 1966 u martua me miken e tij të fëmijërisë, Stella Saba, me origjinë greke. U vendosën në Shën Pitersberg të Floridës. Prej andej nuk u shpërngul më, veçse kur iu desh të fluturonte për udhëtimin e fundit.

Është shkrimtar tejet i veçantë. Shkrimi

i tij karakterizohet prej refuzimit për të përshtatur formën me përmbajtjen, nga një negociim i vazhdueshëm për kufijtë e shprehjes, shkrimit të lirë, spontanitetit dhe subjektivizmit. Forma e tij është e papërpunuar, pothuajse inekzistente, me paragrafë të palidhur midis tyre dhe fjalor të varfër dhe të përsëritur. Ç'mbetet, atëherë? Pikërisht këtu është magjia. Kjo "letërsi e çrregullt" pothuajse "jerm", gati "të shpërbëhet", ka megjithatë bukurinë e saj tërheqëse. Mendimi i tij "i pakontrolluar" të shtyn të ëndërrosh në ekstazë botëra dhe kohëra të tjera, sa abstrakte aq edhe reale, të ngjan se rron në një "shtëpi xhamash", gati të shpërbëhen.

Tek hyrja e romanit "Në rrugë", padyshim vepra e tij më e njohur dhe më e mirë, e cila u shkrua vetëm në tre javë, sikur shkrimtari "ishte vënë në prizë" dhe gjendej në ekstazë dehjeje, libër pa pjesë dhe paragrafë - një tërësi dhe kaq - Keruak do të shkruante: "Të vetmit njerëz që ekzistojnë për mua janë të çmendurit, ata që çmenden për të jetuar, që çmenden për të folur, çmenden për të shpëtuar, që i duan të gjitha njëkohësisht, ata që kurrë nuk gogësojnë ose thonë qoftë edhe një thënie të zakonshme, por që digjen si qirinjtë e verdhë mitikë të romakëve, që shpërthejnë si fishekzjarre mes yjeve dhe nga brenda tyre çlirohet dritëza blu e zemrës së tyre, dhe ata që i shikojnë ia bëjnë: Aaaa!!!, të mrekulluar..."

Vitet e fundit të jetës vuajti abandonimin thuajse total të botës botuese dhe denigrimin e përhershëm nga kritika letrare ekzistuese.

Vdiq 46 vjeçar, në urgjencën e "St. Anthony's Hospital" të Floridas, nga një hemorragji në stomak. U varros në vendlindjen e tij, në Louel. Pak më parë i ishte bërë një përshpirtje lamtumire në kishën e St. Jean Baptiste, ku ndiqte meshat kur ishte i vogël.



Profile: Janis Joplin

# KËNGËTARJA QË NDRYSHOI PËRGJITHMONË ROCK-un



**Doza e dhimbjes së grumbulluar, në vitet e mëparshme, u kthye të përshkonte me forcë dërrmuese. Kordat e saj vokale ishin të forta, gjëmuese dhe të pjekura. Ajo ishte ende vajza e pasigurt dhe e vuajtur e së kaluarës. Në skenë bën që 25,000 njerëz të dashurohen, pastaj shkon vetëm në shtëpi**

Ajo ishte një nga këngëtarët më të mëdha të shekullit XX, me sukses të jashtëzakonshëm dhe një grup po aq të madh ndjekësish. Por, ajo ishte gjithashtu një grua e vetmuar, e trishtuar, e përpurë nga ndjenja dhe komplekse konfliktuale, që zhdukeshin sa herë që ecte në një skenë. Sepse, atëherë ajo u bë luanesha e fortë dhe e vendosur, që të gjithë e njihnin. Megjithatë, në thellësitë e saj ajo gjithmonë mbeti një grua e pasigurt, e konsumuar nga teprimet.

## Historia e vërtetë e Janis Joplin

19 janar 1943: Një yll lindi në Port Artur, Texas. Në qytetin e vogël të naftës, Dorothy East, punonjëse dhe Seth Joplin, inxhinier i ndërmarrjes së naftës Texaco, sollën Janisin e vogël në botë, duke i kushtuar të gjithë vëmendjen. Fëmija rritet e qetë, midis shenjave të para të një pasioni që së shpejti do të shndërrohet në një thirrje të vërtetë. Në shkollë ajo tregon se është e prirë për çdo formë arti, veçanërisht për të kënduar. Por shokët e saj të shkollës, prej moshës së re, tallen me të. Ata e vënë në lojë për atë pamje disi të fortë dhe për zgjedhjen e veshjes së rrobave më pak femërore. E bënë edhe sepse në ato ditë, Janis nuk i fshihte idealet e saj të lirisë dhe barazisë. Ngacmimet shpejt kthehen në komplekse dhe ankthe, veçanërisht kur trupi i saj ndryshon në moshën katërmëdhjetë vjeç. Ajo shton në peshë dhe nuk e pëlqen veten. Por ka muzikën, dhe tek ajo strehohet. Ndërkohë, prindërit e saj merren me vëllezërit e motrat e tjera, që marrin vëmendjen dhe kujdesin e rezervuar dikur për të.

Por koha kalon dhe për Janis është koha të regjistrohet në universitet. Problemet vazhdojnë, mungesa e atraktivitetit bëhet objekt talljeje mes djemve në kampus, që e votojnë atë si "njeri-

un më të shëmtuar". Prindërit mungojnë gjithnjë e më shumë dhe ajo, edhe një herë, gjen strehë në muzikë, midis izolimit nga pjesa tjetër e botës dhe atyre plagëve që bëhen gjithnjë e më të thella, me çdo ditë që kalon. Mungesa e tolerancës e qytetit të Teksasit, ku ajo lindi dhe u rrit, shkon dorë për dorë me dëshirën e saj për liri dhe me nevojën pothuajse obsesive për shpengim dhe pranim. Në 1963 Janis vendosi të linte universitetin dhe të transferohej në San Francisko. Qyteti e mirëpret atë: më në fund është e lirë të shprehet, pa u përmbajtur. Por rebelimi i saj përshin gjithashtu abuzimin me drogën dhe alkoolin. As hitet e hershme muzikore nuk e lejojnë të gjejë paqen që po kërkonte. Miqtë e rinj janë të shqetësuar për të dhe, me një biletë vetëm vajtje për në Teksas, e ftojnë të vijë në shtëpi për t'u takuar përsëri. Janis e bën.

## Hitet e para muzikore

Në 1966 Janis vendosi të kthehej në San Francisko dhe u bashkua me Big Brother dhe The Holding Company, së pari duke luajtur dajren, pastaj duke u bërë soliste. Publiku e brohoret, Janis e pëlqen. Konfirmimi vjen me pjesëmarrjen në Festivalin Monterey, kur para një publiku, zëri i saj i mrekullueshëm gërvisht zemrat e dëgjuesve. Një performancë e paharrueshme që e shtyu Columbia Records të firmoste me grupin e saj. Janis është ende e papjekur, por është unike, krejt ndryshe nga të gjitha këngëtarët e asaj kohe. Ajo bëhet lidere, duke qenë më e suksesshme se anëtarët e tjerë, të cilët janë të gjithë burra. Cheap Thrills doli në gusht 1968. Disa javë dhe pushton pozicionin e parë në renditje, duke e mbajtur atë rekord për dy muaj. Grupi fitoi Gold Disc, por po atë vit ata u ndanë.

Një vendim i përbashkët – do të tregonin ata vetë – i lindur nga vetëdija se fati i Janis ishte diku tjetër. Megjithatë, ajo zgjedhje, e cila nuk ishte asgjë tjetër veçse parathënie e karrierës së saj solo, e zhyt Janis në gabimet e rinisë: ajo fillon të abuzojë përsëri me alkoolin dhe drogën. Doza e dhimbjes së grumbulluar, në vitet e mëparshme, u kthye të përshkonte me forcë dërrmuese. Kordat e saj vokale ishin të forta, gjëmuese dhe të pjekura. Ajo ishte ende vajza e pasigurt dhe e vuajtur e së kaluarës. Në skenë bën që 25,000 njerëz të dashurohen, pastaj shkon vetëm në shtëpi.

## Suksesi, dështimi dhe dashuria

Me grupin e porsalindur Cosmic Blues, zëri më i madh "blues" në historinë e rock-ut, arrin pjesën tjetër të botës. Albumi i saj solo, "I got Dem Ol' Cosmic Blues Again Mama!", ndan kritikët dhe audiencat. Janis kritikohet, madje ashpër, dhe ato dobësi që nuk janë zhdukur kurrë kthehen në sipërfaqe me forcë. Miqtë janë të shqetësuar për të, por ajo lufton me demonët e vet çdo ditë, ose të paktën përpigjet. Një turne evropian fillon në 1969, por pritja nga publiku nuk është ajo për të cilën këngëtarja shpreson. Pjesëmarrja në Festivalin e Woodstock gjithashtu dëshmon të jetë një dështim: ndërsa ishte duke pritur të dilte në skenë – rreth 10 orë pas fillimit të koncertit – Janis merr një dozë të rëndë ilaçesh, që e rrezikojnë karrierën e saj. Performanca është plot me paqëndrueshmëri dhe publiku nuk e vlerëson. Duke ndjekur historinë, ajo zgjedh të ndryshojë jetën e vet: lëviz në Brazil dhe braktis teprimet. Këtu takon David Niehaus dhe një dashuri e madhe do të lindë mes të dyve. Burri do ta mbështesë dhe do ta ndihmojë gjatë gjithë kohës

për ta larguar nga teprimet, por pa pasur sukses.

## Shansi i fundit

Janis kthehet në Amerikë dhe formon një grup të ri – më të fundit – Full Tilt Boogie Band. Ajo është pozitive dhe optimiste dhe e jeton atë moment të jetës së saj me entuziazëm, duke braktisur drogën për një farë kohe. Në qershor 1970 ishte protagoniste, me grupin e saj, e një turne të organizuar në bordin e një treni në lëvizje, Festival Express 1970. Performansat e saj janë perfekte dhe Janis është më e shkujdesur se kurrë, deri në pikën që ajo madje gjen kohën për të bërë dashuri: 65 marrëdhënie seksuale në 5 ditë, siç thotë vetë. Suksesi i jashtëzakonshëm i asaj periudhe e solli Paul Allen Rothchild, producentin e The Doors, më afër Janis. Paul është i bindur se ajo ka ndryshuar dhe vendos që t'i japë një shans duke e shtyrë të regjistrojë një album tjetër: Perla. Por Mercedes Benz, një nga këngët më domethënëse nga albumi i nxjerrë pas vdekjes, është e fundit që regjistron Janis Joplin. Më 4 tetor 1970, ajo u gjet e pajetë në dhomën 105 të Hollywood Landmark Hotel në Los Angeles. Raporti mjekësor nuk lë dyshim për shkakun e vdekjes: mbidozë heroine. Kështu vdes në moshën 27 vjeç, një nga zërat më të bukur dhe intensivë të skenës muzikore të të gjitha kohërave. Janis bashkohet me klubin e 27, duke trashëguar mallkimin e artistëve të tjerë të mëdhenj që vdiqën në atë moshë. Trupi i këngëtares u dogj në Varrezat e Parkut Memorial Westwood Village, hiri i saj u shpërnda në Oqeanin Paqësor për të përmbushur dëshirën e saj për të qenë e lirë, sepse në fund të fundit, ajo kishte qenë gjithmonë e tillë. (bota.al)

Film

# SHPËTONI USHTARIN RAJAN

**Një skuadër ushtarësh amerikanë futen në thellësi të armikut me një mision: duhet të tërhiqnin nga fronti i luftës një ushtar. Ai nuk kishte asgjë të çmuar në veten e tij, por për familjen ishte vërtet më se i çmuar. Dhe kish mbetur i vetëm mes katër vëllezërish. Të gjithë të vrarë në të njëjtën luftë...**

## Leonard VEIZI

...Sakrifica e individëve për të mirën e të tjerëve është një nga temat kryesore të Luftës, ku ushtarët janë të gatshëm të rrezikojnë jetën për një shok të tyre, për të ruajtur dinjitetin njerëzor edhe në kushtet ekstreme të luftës. Dhe për këtë temë flet dhe filmi i përbotshëm "Shpëtoni ushtarin Rajan".

## Filmi

"Saving Private Ryan", është një nga filmat më të njohur për temën e Luftës së Dytë Botërore dhe për mënyrën e tij realiste dhe të ashpër të përshkrimit të luftës. Duke vendosur ngjarjet menjëherë pas "Ditës D" apo siç njihet ndryshe "D Day" që ka të bëjë me zbarkimin e aleatëve në Normandi, filmi ndjek grupin e ushtarëve amerikanë të udhëhequr nga Kapiteni Xhon H. Miller - luajtur nga Tom Henks, - të cilët kanë një mision të veçantë: shpëtimin dhe kthimin e një ushtari, Xhejms Fransis Rajan i cili interpretohet nga Mat Demon, - pasi tre vëllezërit e tij janë vrarë në luftë.

Skena fillon me një pamje të vendosur të fushës së betejës, më pas kalon në varkat dhe në këtë skenë ne mund të shohim kamerën duke lëvizur vertikalisht në një mënyrë agresive. Kjo tregon pikat e forta të baticave dhe sa intensive do të bëhet lufta. Skena më pas fillon ndërsa dyert e anijeve hapen dhe njerëzit vriten, duke ilustruar se lufta ka filluar. Filmi portretizon valën e parë të trupave aleate që zbarkonin në plazhin Omaha në Normandinë e pushtuar nga nazistët, në 6 qershor 1944, në një skenë 24-minutëshe që është përshkruar si një nga përshkrimet më brutale të filmit. Pushtuesit pësojnë humbje të mëdha,

me ushtarë që vdesin në ekran në mënyra të ndryshme të frikshme dhe të paparashikueshme.

## Ngjarja

"Saving Private Ryan" është një film epik luftarak amerikan i vitit 1998 me regji të Stiven Spielberg dhe shkruar nga Robert Redat. I vendosur në vitin 1944 në Francë gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai ndjek një grup ushtarësh, të udhëhequr nga kapiteni John Miller, në misionin e tyre për të gjetur privatin Xhejms Fransis Rajan dhe për ta sjellë atë në shtëpi të sigurt pasi tre vëllezërit e tij janë i vrarë në aksion. Kasti përfshin gjithashtu Eduard Bërn, Tom Sajzmo, Barri Peper, Ghiovani Rebisi, Ven Diesol, Adam Goldberg dhe Xheremi Dejvis. Spielberg trajton luftën jo si një akt heroik idealizuar, por si një përvojë brutale që shkakton humbje të mëdha dhe trauma. Skenat në fillim të filmit, ku zbarkimi në Normandi përshkruhet me detaje të dhimbshme, janë shembull i rrallë i përdorimit të realizmit brutal për të paraqitur përvojën e ushtarëve. Përmes portretizimit të marrëdhënieve të ushtarëve dhe vendimeve morale që marrin, filmi vë theksin te rëndësia e humanizmit në luftë. Kapiteni Miller dhe ekipi i tij luftojnë jo vetëm për fitoren, por edhe për mbajtjen e vlerave humane dhe të drejtësisë në një botë të zhytur në dhunë. Spielberg dhe drejtori i fotografisë, Xhanus Kaminski, krijuan një estetikë unike për skenat e luftës, me kamera të lëkundshme dhe ndriçim të zvogëluar, për të krijuar ndjesinë se shikuesit janë në mes të betejës. Kjo teknikë ofron një ndjesi të lëvizshme dhe të paqëndrueshme, duke reflektuar kaosin dhe pasigurinë e luftës. Filmi përdor efekte speciale për të

portretizuar ashpërsinë e luftës. Kjo ndihmon shikuesit të përjetojnë nga afër frikën, dhimbjen dhe vuajtjen e luftëtarëve, duke bërë që filmi të jetë një nga përshkrimet më realiste të luftës në kinematografi.

"Saving Private Ryan" u vlerësua në mënyrë kritike për portretizimin realist e të palëkundur të terrorit të luftës. Shumë recensues gjithashtu vlerësuan performancën e Tom Henks. Megjithatë, disa kritikë e gjetën skenarin konvencional, klishe dhe sentimental. Filmi ishte një sukses komercial, duke fituar më shumë se 480 milionë dollarë në mbarë botën, duke e bërë atë filmin e dytë me fitimin më të madh të vitit 1998. "Saving Private Ryan" fitoi pesë çmime Oscar, duke përfshirë çmimin për regjisorin më të mirë, dhe filmi është vlerësuar me interesin e rinovuar për Lufta e Dytë Botërore në fillim të shekullit të XXI dhe frymëzimi i shumë prej filmave të luftës që e pasuan. Filmi fitoi dhe çmimet Golden Globe, Academy, BAFTA dhe Saturn.

"Saving Private Ryan" konsiderohet si një nga filmat më të mirë të realizuar ndonjëherë. Teknikat e saj të xhirimit të skenës së betejës ndikuan në shumë filma të mëvonshëm të luftës, aksionit dhe superheronjve, dhe regjisorë të shumtë kanë përmendur "Saving Private Ryan" si ndikim. Në vitin 2014, filmi u zgjodh për t'u ruajtur në Regjistrin Kombëtar të Filmit të Shteteve të Bashkuara nga Biblioteka e Kongresit si "kulturor, historikisht ose estetikisht i rëndësishëm".

## Skenari

"Saving Private Ryan" u frymëzua nga historitë e familjeve ushtarake që pësuan humbjen e disa anëtarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Skenari i filmit

u mbështet nga një histori e vërtetë që i përkiste Luftës së Dytë Botërore, historia e vëllezërve Niland. Vëllezërit Niland ishin katër vëllezër amerikanë që shërbenin në forcat e armatosura gjatë luftës, dhe kur tre prej tyre u raportuan të vrarë, autoritetet amerikane vendosën të kthenin në shtëpi vëllain e mbetur gjallë, Fritz Niland, për të mos rrezikuar që familja e tij të humbiste të gjithë djemtë.

Kohë më pas, një nga vëllezërit e Niland, i cili besohet se kishte vdekur, u lirua nga një kamp burmez i të burgosurve të luftës (POW) dhe u kthye në shtëpi para përfundimit të luftës.

Kritika në shtypin e përditshëm është shprehur se "Shumë veteranë të Luftës së Dytë Botërore që ndoqën filmin raportuan se ata gjetën se skenat e luftimit ishin tepër realiste, madje duke shkruar më larg aq sa folën dhe pët shkaktimin e simptomave të tyre të çrregullimit të stresit post-traumatik.

## Mesazhi

A ia vlen të sakrifikosh jetën e 8 ushtarëve për të shpëtuar ushtarakun Ryan?

Me këtë film, Steven Spielberg krijoi një nga filmat e tij më të mëdhenj, një tablo luftime të modës së vjetër me sekuenca beteje tejet bindëse dhe të guximshme. "Saving Private Ryan" ngre pyetje të thella etike mbi vlerën e jetës dhe përkushtimin për të shpëtuar jetën e një individi përkundrejt sakrificës së shumë të tjerëve. Ai nxit reflektimin mbi peshën e humbjeve njerëzore në luftë dhe kuptimin e heroizmit në kontekstin e përpjekjeve për mbijetesë dhe nder. Spielberg krijon një përvojë emocionale që bën thirrje për paqe dhe respekt për sakrificat e atyre që kanë luftuar për vlerat njerëzore.



NUMRI I ARDHSHEM ME 15 DHJETOR

# HEJZA

30 Nëntor 2024

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:  
**Drian Shala - Shala & Rexhepi**

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000